



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Teknikë e Lartë në
Laboratorë Mjekësorë”
Kolegji Universitar “Logos”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Anila HODA

Prof.Asoc. Etleva REFATLLARI

Janar / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Logos”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në: Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 1, datë 06.01.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr. 479, datë 16.12.2015
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.568, datë 03.11.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 50, datë 05.07.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE / 6 PAK Bazuar në ngarkesën mësimore rezulton: 74.4 % PAE /25.6 % PAK
18	Numri i studentëve:	– 2019-2020 27 studentë; – 2020-2021 30 studentë; – 2021-2022 40 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Kolegji Universitar “Logos”. KU Logos ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin 2017 dhe riakredituar në nivel institucional në vitin 2021 me vendim të BA nr.58, datë 16.12.2021, për një periudhë 4 vjeçare. Programet e studimit që ofron Departamenti i Shkencave Mjekësore janë akredituar dhe janë në proces riakreditimi periodik nga institucionet përgjegjëse. Përmes programit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” synohet përgatija e profesionistëve me formim 3 vjeçar në fushën laboratorike mjekësore në funksion të sigurimit të mbulimit shëndetësor universal dhe në mënyrë specifike të ofrimit të shërbimit laboratorik klinik, biokimik, mikrobiologjik, histopatologjik në funksion të diagnozës, monitorimit dhe parandalimit. Programi është liçensuar nga MASH me Urdhër Nr. 1, datë 06.01.2011, me emërtimin Bachelor në “Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësor”. Sipas urdhërit të MAS Nr. 479, datë 16.12.2015, është ndryshuar emërtimi i programit të studimit Bachelor në, “Teknikë e lartë në laboratorë mjekësorë”. Programi është riakredituar në vitin 2019, me VBA Nr.50 datë 05.07.2019 të Bordit të Akreditimit, dhe ka marrë akreditim 3 vjeçar.

Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet në përputhje me kërkesat aktuale dhe ka një ndërthurje të mirë të teorisë me praktikën që mundëson formimin profesional të studentëve. Programi i studimit realizohet me 180 ECTS dhe kohëzgjatja normale e tij është tre vite akademike. Programi organizohet në lëndë dhe module të integruara në përputhje me aktet ligjore në fuqi, konkretisht me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr. 41 datë 24.01.2018.

Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personalitete të spikatur në fushën e mjekësisë laboratorike, si dhe nga mjekë të rinj. Institucioni ndjek një politikë për rinovimin e stafit akademik duke u përballur edhe me vështirësitë për rekrutimin e stafit akademik të specializuar

Institucioni ka vendosur përparësitë e veta strategjike sic janë fuqizimi i kapaciteteve të laboratorëve ekzistues dhe për këtë ka rinovuar hapësirat e laboratorëve, si dhe ka investuar në paisjen e tyre me teknologji bashkëkohore për të mundësuar aftësimin praktik dhe shkathtësimin në veprimet profesionale të studentëve. Institucioni ka në fokus rritjen e cilësisë së mësimdhënies, rritjen e kohës së praktikës mësimore, bashkëpunimin me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit mbështetur në marrëveshje bashkëpunimi midis palëve.

Institucioni bashkëpunon me institucione të ndryshme publike dhe private, ku mundëson jo vetëm formimin profesional të studentëve, por edhe ndihmon dhe mbështet studentët në rrugën e punësimit dhe rezulton që një përqindje e lartë e studentëve punësohen në profesion direkt pas diplomimit



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është akredituar sipas legjislacionit Shqiptar me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 50, datë 5.07.2019, me vlefshmëri maksimale prej 3 vitesh akademike. BA ka lënë disa rekomandime për këtë program studimi, të cilat janë plotësuar nga institucioni si më poshtë

1. Institucioni të rekrutojë staf të ri akademik efektiv të specializuar në fushën e Mjekësisë Laboratorike;

Në përmbushje të rekomandimit institucioni ka rekrutuar:

- a. Një staf akademik efektiv me Diplomë Universitare në Mjekësi të Përgjithshme dhe specializim në fushën e mjekësisë laboratorike, profili Klinik-biokimik.
- b. Një staf akademik efektiv me diplomë universitare në biologji dhe gradë shkencore PhD në Gjenetikë dhe Biologji Molekulare në Departamentin e Shkencave Mjekësore;
- c. Një staf ndihmës akademik të paisur me Diplomë Bachelor dhe Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë dhe me eksperiencë pune në laborator;
- d. Të dy anëtarët e rekrutuara nga KU LOGOS ishin të pranishme në takimet e organizuara nga GVJ me stafin akademik;

2. Institucioni të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi me qëllim:

- a. Uljen e krediteve në lëndët Kimi inorganike dhe organike;
- b. Uljen e krediteve në lëndët Sigurim Teknik dhe Biosiguri, ose realizimin e tyre në një modul të kombinuar;
- c. Shtimin e temave të Biofizikës dhe Optikës;
- d. Shtimin si lëndë të veçantë ose cikël leksionesh të Automatiti në Laboratorët Mjekësorë dhe Sistemet e Informatizimit Laboratorik;

Në përputhje me rekomandimin për rishikimin e planit mësimor referuar uljes së krediteve në lëndët kimi inorganike dhe organike, si dhe uljen e krediteve në lëndët Sigurim Teknik dhe Biosiguri institucioni ka ulur kreditet e lëndës Kimi Inorganike deri në 4.5 ECTS, në Biosiguri 4.5 ECTS. Gjithashtu, temat e sigurimit teknik u integruan në modulin e lëndës “Biosiguri” dhe lënda “Deontologji” realizohet si lëndë e veçantë me 3 ECTS. Për të shtuar temat e biofizikës dhe optikës, është shtuar lënda e re “Fizikë optike” me 3 ECTS. Rekomandimit për shtimin si lëndë e veçantë ose me cikël leksionesh të Anatomisë në Laboratorë Mjekësorë dhe Sistemet e Informatizimit Laboratorik, institucioni i është përgjigjur duke futur lëndëm “Menaxhim dhe kontroll i cilësisë në laboratorët mjekësorë” me 3 ECTS.

- a. Lënda Histopatologji me 3 ECTS u organizua me synim shtimin e orëve laboratorike në fushën e laboratorit histopatologjik, dhe temat trajtohen në Histopatologji me 3 ECTS dhe Teknika laboratorike në Histopatologji me 4.5 ECTS;
- b. është shtuar lënda e Gjenetikës me 3 ECTS;
- c. Eshtë shtuar cikli i leksioneve të Bisotatisikës me 3 ECTS;

3. Institucioni të përmirsojë literaturën në gjuhën shqipe, kryesisht për lëndët bazë të programit të studimit;

Institucioni ka pasuruar literaturën me 154 tituj nga të cilët 137 në gjuhën shqipe, si dhe ka bërë dixhitalizimin e bibliotekës, duke plotësuar kështu rekomandimin për të përmirësuar literaturën në gjuhën shqipe dhe kryesisht për lëndët bazë të programit të studimit. GVJ e konfirmoi këtë investim të KU LOGOS gjatë vizitës në bibliotekën e korpusit qendror në Tiranë.


4. Institucioni të sigurojë furnizimin me reagent dhe pajisje laboratorike përgjatë gjithë vitit mësimor në mënyrë që të mos ketë mungesa gjatë zhvillimit të praktikave laboratorike;

Për të siguruar furnizimin me reagentë dhe pajisje laboratorike përgjatë gjithë vitit mësimor, institucioni planifikon çdo vit një fond të veçantë për plotësimin e kërkesave. GVJ vizitoi laboratorët mësimor të KU Logos dhe vuri re një përmirësim të ndjeshëm të infrastrukturës laboratorike krahasuar me periudhën para 3 vitesh.

5. Institucioni të rishikojë marrëveshjet e bashkëpunimit, duke i dhënë përparësi laboratorëve që e ofrojnë teknologjinë laboratorike më bashkëkohore;

KU Logos ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me laboratorë që kanë investuar në teknologji bashkëkohore. Gjithashtu institucioni ka rinovuar marrëveshjet e bashkëpunimit me disa universitete dhe laboratorë në shërbim të praktikave laboratorike. Janë vendosur marrëveshje me universitete ndërkombëtare, kryesisht në Greqi. Kështu KU Logos ka plotësuar rekomandimin për rishikimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me fokus laboratorët që ofrojnë teeknologji laboratorike më bashkëkohore.

GVJ konkludon se KU LOGOS i ka plotësuar **plotësisht** të gjitha rekomandimet e akreditimit të mëparshëm.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Teknikë e lartë në laboratorë mjekësorë" të ofruar nga Departamenti i Shkencave Mjekësore, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

GVJ përbëhej nga Prof Asoc. Etleva Refatllari dhe Prof.Dr. Anila Hoda. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. GVJ shfrytëzoi RVB, si dhe një numër të konsiderueshëm evidencash të ndryshme, të cilat iu vunë në dispozicion mjaft kohë përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVJ u familjarizua me strukturën, politikat, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore të kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i Departamentit të Shkencave Mjekësore. GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, çka i mundësoi ekipit vlerësues të kuptojë më qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të ndryshëm, autoritete drejtuese, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të procesit mësimor, dhe aktiviteteteve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambjentet e brendshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin e studimit. GVJ vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën etj. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet e mëposhtme:

Për fushën e parë të vlerësimit: "Ofrimi i programeve të studimit" grupi i vlerësimit të jashtëm nuk evidentoi ndonjë praktikë të mirë, dobësi, rekomandim apo afirmim. Programi i Studimit Bachelor: "Teknikë e lartë në Laboratorët Mjekësorë" i përmbush të gjitha standartet e vlerësimit të fushës së parë. Programi i studimit është në përputhje me misionin, statutin dhe rregulloret e Institucionit. Institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike dhe private, laboratorë që kanë investuar në teknologji bashkëkohore. në funksion të realizimit të programit të studimit, kryesisht në mbështetje të formimit profesional të studentëve. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 1 përmbushet plotësisht.**

Për fushën e dytë të vlerësimit: "Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit" GVJ nuk evidentoi ndonjë praktikë të mire apo afirmim. Programi i studimit ka një ndërthurje harmonike të koncepteve teorike me praktikën në auditor dhe praktikën profesionale.

GVJ konstatoi se nuk ka diferenca në numrin e ECTS për secilën lëndë por vetëm ndryshime në ndarjen e orëve midis leksioneve, seminareve dhe laboratoreve për disa lëndë. Gjithashtu, titullarët e disa lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor siç e kërkon ligji i arsimit të lartë. Në disa prej syllabuseve mungonte përcaktimi i tipologjisë së lëndëve dhe shpërndarja e orëve në auditor nuk përputhej me të dhënat e tabelave të planit mësimor.

GVJ konkludon se programi i Studimit Bachelor: "Teknikë e lartë në Laboratorët Mjekësorë" i përmbush plotësisht të gjitha standartet e vlerësimit të fushës së dytë, përveç



Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



standartit II.1 I cili përmbushet kryesisht. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 2 përmbushet plotësisht.**

Për fushën e tretë të vlerësimit: "Mësimdhënia, mësimxënia, vlerësimi dhe kompetencat" GVJ grupi i vlerësimit të jashtëm nuk evidentoi ndonjë praktikë të mirë, dobësi, rekomandim apo afirmim. Programi i Studimit studimit Bachelor: "Teknikë e Lartë në Laboratorët Mjekësorë" i përmbush të gjitha standartet e vlerësimit të fushës së tretë. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 3 përmbushet plotësisht.**

Për fushën e katërt të vlerësimit: "Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit" GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të stafit janë transparente. Infrastruktura, mjediset mbështetëse janë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe formimit praktik të studentëve. Institucioni ka bërë përpjekje të vazhduara për të pasuruar bibliotekën me burime të reja literature, kryesisht shqiptare, duke përmbushur dhe rekomandimet e akreditimit të mëparshëm. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 4 përmbushet plotësisht.**

Për fushën e pestë të vlerësimit: "Studentët dhe Mbështetja e tyre", GVJ nuk evidentoi ndonjë praktikë të mirë, dobësi, rekomandim apo afirmim. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 5 përmbushet plotësisht.**

Për fushën e gjashtë të vlerësimit: "Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit" GVJ evidentoi pikë të fortë bashkëpunimin e mirë me institucione partnere, gjë që u mundëson studentëve të LOGOS të kryejnë pranë këtyre institucioneve praktikat profesionale, ose u mundëson punësimin studentëve, pas përfundimit të studimeve **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 6 përmbushet plotësisht.**

Vlerësimi i përmbledhur

Grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon Bordit të Akreditimit, se standartet për programin e studimit Bachelor: "Teknikë e Lartë në Laboratorët Mjekësorë" ofruar nga Departamenti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Kolegji Universitar "Logos". **përmbushen plotësisht.**

Kolegji Universitar "LOGOS", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 06.12.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 149 / 16 Prot, datë 06.12.2022. Kolegji Universitar "LOGOS", përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 310/2 Prot, datë 09.12.2022, "Përgjigje tuajës 149 / 16 Prot, lidhur me dërgimin e draft raportit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit", ku shpreh dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Drafti merr formën e Raportit Final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Shkolla e Lartë Private (SHLP) Logos u krijua në vitin 2009 (liçensuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1055 dt. 29.07.2009). Ky institucion i arsimit të lartë u ngrit mbi eksperiencën 10 vjeçare të Institutit të Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, shkollë jo publike 2 vjeçare, një ndër të parat shkolla profesionale për përgatitjen e Laborantëve Mjekësorë. Në vitin 2017, SHPL Logos mori statusin Kolegji Universitar (KU) Logos (Urdhër i Ministres së Arsimit dhe Shkencës Nr. 93, dt. 06.03.2017) <i>(Aneks I)</i></p> <p>Në nenin 3 të Statutit të institucionit theksohet se KU Logos ka për mision të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. <i>(Aneks II/1)</i></p> <p>Programet e studimit të ofruara nga KU Logos janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar të arsimit të lartë dhe i përgjigjen interesave kombëtare në fushën e arsimit të lartë. Në mënyrë specifike, Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë. Programi synon përgatitjen e profesionistëve me formim 3 vjeçar në fushën laboratorike Mjekësore në funksion të sigurimit të mbulimit shëndetësor universal dhe në mënyrë specifike të ofrimit të shërbimit laboratorik klinik, biokimik, mikrobiologjik, histopatologjik në funksion të diagnozës, monitorimit dhe parandalimit. <i>(Aneks II/2, 3.1, 3.2, 3.3)</i></p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programet e studimeve të ofruara nga KU Logos, ofrojnë një arsim të lartë cilësor dhe edukim të brezit të ri me vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Misioni i programit të studimit Bachelor në Teknikë e Lartë në laboratorët Mjekësorë <i>(Aneks II/3.3)</i> i sanksionuar në rregulloren e tij është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor, me synimin të</p>

	<p>formojë specialist të lartë në fushën e laboratorëve mjekësorë në përputhje me prioritetet e vendit. Në program gjejmë një harmonizim të njohurive teoriko-praktike, të traditës dhe inovacionit. Zhvillimi strategjik i programit mësimor synon rritjen e kapacitetit teorik-praktik profesional të studentëve në përputhje me nevojat aktuale dhe perspektivën e shërbimit laboratorik mjekësor në vend. <i>(Aneks II/4.1)</i></p> <p>KU Logos ka krijuar traditë në transmetimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare përmes aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga institucioni. <i>(Aneks V/4, 5, 6)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara i Kolegjit Universitar Logos.</p> <p>Programi është Liçensuar nga MASH në vitin 2011 <i>(Aneks 0/2)</i> dhe është riakredituar në vitin 2019 <i>(Aneks 0/13)</i>. Me VBA 50 datë 05.07.2019 të Bordit të Akreditimit, programi Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ka marrë akreditim 3 vjeçar.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë. Ai përmban elementët e domosdoshëm për të përmbushur misionin dhe për të realizuar objektivat për formimin e thelluar teorik – praktik të specialistëve në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. <i>(Aneks II/3.1, 3.2, 3.3, Syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Zhvillimi social dhe ekonomik i vendit në përgjithësi dhe ambicia për integrim në hapësirën europiane kërkon burime njerëzore të kualifikuara me një bazë të gjerë dhe të përshtatshme dijesh. Mendojmë se ky program studimi është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe integritit. Nga vlerësimi i RVB dhe dokumentacionit shoqëruar GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet në përputhje me zhvillimin lokal dhe kombëtar dhe ndihmon në zhvillimin e shërbimit shëndetësor në përputhje me kërkesat e kohës. Programi i studimit ka një ndërthurje të mirë të teorisë me praktikën që mundëson formimin profesional në fushën e laboratorëve biokimikë, klinikë, mikrobiologjikë dhe histopatologjikë. <i>(Aneks II/1, 2, 3.3, Syllabuset)</i></p>

Attado *celle fellesee*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar një plan të zhvillimit për vitet 2018-2024, që synon së pari kalimin nga kolegji universitar në universitet. Prioriteti i dytë strategjik është përmbushja e standarteve akademike përmes përmirësimit të kurrikulave dhe procesit të mësimdhënies në funksion të kërkesave aktuale të vendit dhe në përshtatje me kërkesat e tregut të punës (<i>Aneks II/4</i>). Plani i zhvillimit parashikon hapjen e programeve të reja dhe riorganizimin e programeve ekzistuese. Kërkimi shkencor, ndërtimi i partneritetit, ndërkombëtarizimi dhe sigurimi i cilësisë janë gjithashtu prioritetet e planit strategjik.</p> <p>Plani i zhvillimit ka përcaktuar për Departamentin e Shkencave objektiva të rëndësishme në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe angazhimit shoqëror si dhe parashikon strategjitë e zbatimit. (<i>Aneksi II/4.2, 4.1</i>)</p> <p>KU Logos reflekton një mjedis dinamik ku gërshetohet tradita me kërkesat e aktualitetit dhe zhvillohet në përshtatje dhe zbatim të strategjisë për zhvillim të institucionit. Kjo frymë përparimi dhe ndryshimi u vu re dhe në takimet e GVJ me personelin akademik dhe drejtuesit e institucionit si dhe në vizitat e ambienteve të laboratorëve. (<i>Vizita në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në statutin dhe rregulloren e institucionit përcaktohen qartë drejtimit prioritar akademike. KU Logos synon të pregatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në programet e studimit dhe profilet përkatëse të miratuara, të kryejë studime e kërkime shkencore në fushat dhe sektorët që mbulon në bashkëpunim me institucione homologe e sipërmarrje private si dhe të hyjë në mardhënie bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet në përputhje me drejtimit akademike të institucionit. Rregullorja e programit të</p>

	studimit është hartuar në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit. (Aneks II/1, 2, 3.1, 3.2, 3;3)			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Kolegjin Universitar Logos. Riorganizimi dhe emërtimi i departamenteve të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara është bërë me vendim të Senatit Akademik Nr. 23 datë 11.09.2019 (Aneks I/5) për një përputhje më të mirë me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që ky riorganizim të pasqyrohet dhe në tabelat e përgjithshme të organiogramës së institucionit në statut dhe rregulloret e përgjithshme.</i></p> <p>Titulli i programit të studimit është miratuar bazuar në legjislacionit Shqiptar për arsimin e lartë. GVJ vlerëson se Programi Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit duke respektuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Programi kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve; – Emërtimi përputhet me fushën specifike të studimit; – Programi organizohet në lëndë dhe module të integruara të cilat vlerësohen me kredite ECTS; – Programi strukturohet në 6 semestra akademike, 3 vite dhe 180 ECTS në total; – Në ndarjen e lëndëve janë respektuar kriteret ligjore shqiptare në fuqi (VKM 41 datë 24.01.2018); 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në	Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” janë shkruar qartë objektivat

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>për formimin e studentëve në këtë fushë. <i>(Aneks II/3.3)</i> Programi synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'u japë studentëve njohuritë bazë teorike në fushën specifike mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme dhe të avancuara; - të pregatisë specialistë në fushat e laboratorëve klinik, biokimik, mikrobiologjik dhe histopatologjik; - të pregatisë specialist laboratory të aftë të përdorin teknologjinë bashkëkohore; - të pregatisë studentë të aftë për të vazhduar studimet universitare të ciklit të dytë duke rritur mundësitë e karrierës profesionale; <p>Realizimi i objektivave bëhet i mundur përmes formimit teoriko-praktik që ofron programi i studimit.</p> <p><i>(RVB, tabelat përmbledhëse-plani mësimor, Syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet nga KU Logos që nga viti 2011. Institucioni dokumenton se kryen studim të tregut të punës për programin e studimit. Ai gjithashtu ka një politikë marketingu të dedikuar për këtë program studimi. Në studimin e tregut është bërë një analizë e gjerë e shërbimit laboratorik spitalor e ambulator, publik dhe privat në Shqipëri si dhe analizë e numrit dhe gamës së ekzaminimeve laboratorike që ofrohen nga ky sistem. Institucioni analizon dhe kapacitetet me synimin e përmirësimit për të ofruar konkurrencë të denjë në tregun e punës. Institucioni çmon se ky program ka hapësira të mira punësimi në tregun shqiptar dhe me gjerë.</p> <p>Në takimet në institucion GVJ u informua se rreth 75% e studentëve punësohen në profesion direkt pas diplomimit. Vitet e fundit janë shtuar ofertat e punësimit nga partnerët. Po ashtu ka vende në rajon e më gjerë që e njohin dhe ekuivalentojnë kurrikulën e këtij programi studimi. Në tabelën 23 të RVB jepen të dhënat e detajuara të punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi në tre vitet e fundit akademike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për periudhën 2018-2019 janë diplomuar 35 studentë prej të cilëve 27 janë punësuar në profesion; - Për periudhën 2019-2020 janë diplomuar 7 studentë prej të cilëve 5 janë punësuar në profesion; - Për periudhën 2020-2021 janë diplomuar 26 studentë prej të cilëve 18 janë punësuar në profesion;

Alto *Prof. Dr. M. M. M. M.*

	<p>Në takimet me studentët dhe përfaqësuesit e zyrës së këshillimit të karrierës u theksua se është rritur interesi për të ndjekur programin e ciklit të dytë “Master Profesional” në këtë fushë studimi. Po ashtu u theksua se në politikat e gjurmimit të punësimit si dhe në shtimin e ofertave të punësimit një rol të rëndësishëm luan dhe rrjeti Alumni.</p> <p><i>(Aneks III/5.1, 5.2, VII/2.4, VII/9.1, takimi me përfaqësuesit e zyrës së këshillimit të karrierës dhe RVB)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” janë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Ato garantojnë përftimin e kompetencave, për të qenë konkures në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p><i>(Aneks II/3.3)</i></p> <p>Institucioni ka rinovuar hapësirat e laboratorëve si dhe ka investuar në paisjen e tyre me teknologji bashkëkohore për të mundësuar aftësimin praktik dhe shkathtësimin në veprimet profesionale të studentëve. Numri i vogël i studentëve në grupet e laboratorëve lejon manipulimin individual dhe aftësimin profesional të çdo studenti. Përgatitja në këto laboratorë nën mbikqyrjen e profesionistëve të fushës i siguron studentit kompetencë në manipulimet praktike në situatë të ndryshme diagnostike. <i>(Vizita në ambientet e laboratorëve)</i></p> <p>Praktika profesionale në laboratorë partnerë është një komponent i rëndësishëm i programit. Institucioni ka marrëveshje për kryerjen e praktikave me një numër të madh laboratorësh spitalorë dhe jospitalorë <i>(Aneks VIII/2, 4)</i></p> <p>Praktika mbikqyret nga tutorët sipas një procedure të rregulluar të firmosur nga Përgjegjësi i Departamentit. <i>(Aneks VII/11.2,11.3,11.4)</i></p> <p>Institucioni ka marrëveshje dhe me urdhërin e infermierit në Shqipëri, me të cilin koordinon aktivitetet e licensimit dhe promovimit të karrierës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Atolo


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, takimit në institucion dhe vizitës në ambientet e auditorëve dhe laboratorëve, GVJ konstaton se institucioni ka përvojë të gjatë në ofrimin e programeve të studimit në fushën e Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara i cili përbëhet nga 3 departamente (<i>Aneks I/5</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i shkencave mjekësore; - Departamenti i informatikës së zbatuar dhe statistikës; - Departamenti i shkencave të shëndetit dhe mirëqënies sociale; <p>Departamenti i shkencave mjekësore është përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Fakulteti Fakulteti i Shkencave të Aplikuara për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 27 pedagogë, nga të cilët 14 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 4 kanë gradën Dr./PhD, dhe 5 Asistent Lektorë me Msc; dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD. dhe 3 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i shkencave mjekësore ka 5 PAE dhe 3 PAK.</p> <p>Sipas nenit 3, pika 2 e marrëveshjes me MASR “Për Përcaktimin e Numrit të Personelit Akademik me Kohë të Plotë në Njësitë Bazë në Kolegjin Universitar Logos”, të gjitha departamentet e Kolegjit, do të kenë në përbërje të secilës njësi bazë të paktën 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë, minimalisht 2 (dy), prej të cilëve duhet të zotërojnë gradë shkencore ose titull akademik. Në cdo rast personeli akademik me kohë të plotë në secilën njësi bazë duhet të mbulojë 70% të ngarkesës mësimore. (<i>Aneks No. 3 Marrëveshje MAS, Reduktimi i numrit të personelit akademik në njësine bazë</i>)</p> <p>Institucioni ka përvojën dhe kapacitetet akademike për të përmbushur të gjitha objektivat e programit të studimit. Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personalitete të spikatur në fushën e mjekësisë laboratorike si dhe nga mjekë të rinj (<i>tabelat e RVB, CV e personelit akademik</i>) Institucioni ndjek një politikë për rinovimin e stafit akademik duke krijuar bashkëpunim midis</p>

	<p>profesorëve me pedagogë të rinj në moshë për të siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të departamentit. Në takime u theksua megjithatë vështirësia për rekrutimin e stafit akademik të specializuar. GVJ u njoh me infrastrukturën mësimore që disponon institucioni KU Logos dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ku zhvillohet ky program studimi. Për zhvillimin e programit mësimor KU Logos ka në dispozicion të studentëve salla për leksione dhe seminare të paisura me videoprojektorë, laboratorët e biokimisë, hematologjisë, mikrobiologjisë dhe histopatologjisë të ndërtuar me një konceptim bashkëkohor. (RVB-tabela 16, vizita në institucion)</p> <p>Në dispozicion të studentëve janë dhe ambientet e rinovuara të bibliotekës. GVJ vizitoi ambientet e bibliotekës dhe u informua për rregulloren e funksionimit, listën e librave gjatë takimit me punonjësit dhe përmes shqyrtimit të dokumentave në dosjen e programit. (Aneks IX/7, RVB-tabela 17, vizita në institucion)</p> <p>Salla e re për aktivitete promovuese e paisur dhe me njësinë e përkthimit krijon mundësi për takime e konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare për promovimin e aktivitetit akademik e shkencor të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara. Ky Fakultet ka tre departamente (shih standarti 1.4, kriteri 1) dhe ofron tre programe studimi. Departamenti i Shkencave Mjekësore është përgjegjës për dy programe Bachelor dhe Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ndërsa Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës është përgjegjës për programin Bachelor në Informatikë e Zbatuar. (Aneks II/3.1)</p>
	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet si program me kohë të plotë dhe është kodifikuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe europiane (kodi 725A sipas QSHA). Senati akademik ka miratuar udhëzimin për kodifikimin e lëndëve mësimore të programeve të studimit të ofruara nga KU Logos në zbatim të VKM 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” (Aneks III/4.1)</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”</p>



<p>studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>përputhet plotësisht me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Shkencave Mjekësore që është përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p>Programi kodifikohet në nivelin 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke respektuar direktivat dhe udhëzimet në fuqi. Në realizimin e programit të studimit janë përfshirë staf akademik PAE dhe PAK nga Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqënies Sociale departamente që në fokus kanë shkencat mjekësore të aplikuara. <i>(Aneks II/3.2, 3.3, III/4.1)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në KU Logos ofron 3 programe studimi. Për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore” janë përfshirë si struktura bashkëpunuese Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqënies Sociale. Në realizimin e programit të studimit përfshihen dhe stafi ndihmës dhe administrativ i KU Logos. Organizimi i strukturave realizuese të programit është piramidial dhe funksionon me parimin e bashkëpunimit dhe kontrollit. <i>(Aneks II/3.1,3.2,3.3)</i></p> <p>GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit. <i>(dokumentat e Aneksit I)</i></p> <p>Institucioni bën analizë të vazhdueshme të punës që pasqyrohet në Raportin vjetor të Departamenteve dhe të KU Logos <i>(Aneks II/24, 24.1, 24.2)</i>. Institucioni bën gjithashtu analizë të punës kërkimore të dokumentuar në raportet</p>



	<p>përkatëse. <i>(Aneks V/1.1, 1.2, 2)</i>. Në institucion me vendim senati janë ngritur dhe funksionojnë komisionet e përhershme për garantimin dhe sigurimin e cilësisë dhe për marrdhëniet me studentët <i>(Aneks I/9)</i>. NJSBC jep kontribut në analizën e vazhdueshme të punës përmes grumbullimit dhe analizimit të informacionit si dhe përpunimit dhe krahasimit statistikor të të dhënave në bazë të indikatorëve Europeanë. Në takimin me stafin, pedagogët referuan që janë të përfshirë në procedurat vlerësuese e përmirësuese të syllabuseve, si dhe në hartimin e aplikimin e projekteve kërkimore shkencore. <i>(takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laborator Mjekësor”, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit, institucione spitalore dhe laboratorë privatë si dhe institucione homologe jashtë vendit në kuadër të programit Erasmus+. <i>(RVB-tabela 5, Aneks VIII/1,2,3,4,5.1,5.2,5.3)</i></p> <p>Përmes këtyre marrëveshjeve institucioni ka mundësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Realizimin e praktikës profesionale për studentët; – Realizimin e temave të diplomave; – Mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve; – Realizimin e trajnimeve profesionale; – Realizimin e konferencave ndërkombëtare; <i>(Aneks V/4)</i>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në analizën periodike vjetore të punës së Departamentit të Shkencave Mjekësore raportohet dhe për masën e realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit <i>(Aneks II/24.1, 24.2)</i>. Ky raport siguron informacion lidhur me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperience, kërkim shkencor, mobilitet etj. Të dhënat e raporteve shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
	<p>Synohet shtimi i kontakteve dhe marrëveshjeve në kuadër të programit Erasmus + pasi referuar dhe periudhës 2019-2022, numri i pedagogëve dhe studentëve të përfshirë në mobilitet ka qenë i ulur (3 pedagogë dhe 1 student), shkak për këtë ka qenë situata e jashtëzakonshme me kufuzim të lëvizjes e krijuar nga pandemia COVID19.</p>

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.

Institucioni ka vendosur marrëdhënie me një seri laboratorësh spitalorë dhe jospitalorë për kryerjen e praktikës së mbikëqyrur për programin e studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. *(RVB-tabela 5, Aneks VIII/4)*

Institucioni ka ndërtuar një kuadër rregullator për zhvillimin e praktikës *(Aneks VII/11.1 – 11.5)* Studentët stimulohen të marrin pjesë aktive me punime të realizuara në laboratorët e praktikës në konferencat studentore *(Aneks VII/17)*

Në dy vitet e fundit, si pasojë e kufizimit të lëvizjes prej pandemisë COVID19, u vështirësua mjaft realizimi i praktikës. Institucioni për të mbështetur realizimin e këtij komponenti të rëndësishëm të procesit mësimor përgatiti rregullore dhe udhëzime specifike për praktika në distancë dhe stimuloi marrëveshjet e përkohshme me laboratorë pranë vendbanimeve të studentëve. *(Aneks VII/11.1, takimet në institucion)*

Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

KU Logos organizon në mënyrë periodike trajnime, seminare, dhe konferenca. Institucioni në bashkëpunim me partnerë ka organizuar disa konferenca me pjesëmarrje aktive të lektorëve shqiptarë dhe të huaj. Në takimin me studentët, aktivitetet e organizuara nga institucioni u vlerësuan prej tyre pozitivisht. Studentët shprehen se janë dëgjues por dhe pjesëmarrës aktivë në të tilla projekte. Studentëve iu është krijuar dhe mundësia e intershipeve në qendra laboratorike me të cilat KU Logos ka marrëveshje. Në takimin me stafin dhe koordinatorin e programit GVJ u informua se universiteti ka fond për financimin e projekteve shkencore. Në këtë mënyrë institucioni mbështet aktivitetin shkencor, publikimin dhe raportimin në seminare e konferenca.

(Aneks VII/3.5, 11.5, IX/3.2, takimet në institucion)


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Referuar rregullores së programit të studimit (<i>Aneks II/3.3</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> – Bsc në Teknikë e Lartë në Laborator Mjekësor është program i ciklit të parë të studimeve; korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve; – Studime me kohë të plotë; – Kohëzgjatja e studimeve 3 vite akademike/6 semestra; – Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kriteve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41, të MASR datë 24.01.2018; – Vlerësimi në kredite: 180 ECTS/60 ECTS për vit akademik/4500 orë; – 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit; – Raporti ECTS:orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 1/1.5 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimi është 50 minuta; – Frekuentimi i orëve është i detyrueshëm në masën 75% për orët në auditor (leksione, seminare) dhe 100% për orët e laboratorëve dhe praktikave; – Viti akademik ka 30 javë (secili semester ka 15 javë); – Viti akademik ka 4 sezone provimi: i dimrit-pas përfundimit të semestrit të parë, i verës-pas përfundimit të semestrit të dytë, i paradiplomimit-për studentët e vitit të tretë, i vjeshtës-pas pushimeve verore; – Programi i studimit mbyllet me provim dhe temë diplome;

<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të shërbimit shëndetësor komunitar përmes ofrimit të ekspertizës në diagnozë laboratorike. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës në fushën e mjekësisë laboratorike. Programi synon dhe krijimin e shprehive të veçanta në specialitete si imunologjia klinike, histopatologjia, biologjia molekulare. <i>(tabelat e planit mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” realizohet në 39 lëndë/module të cilat ofrojnë informacion teoriko-praktik të gjerë në fushën e mjekësisë laboratorike. Lëndët e formimit bazë mjekësor dhe të teknikave laboratorike janë pjesë e programit në vitet e para të studimit. Një vend të rëndësishëm në programin mësimor të vitit të tretë ze praktika profesionale e cila i krijon mundësi studentit të ballafaqojë njohuritë e marra në auditor me realitetin praktik diagnostik. Programi në tërësi jep njohuri të përparuara në fushën e studimit të laboratorit mjekësor dhe përgatit specialistë që konkurojnë denjësisht në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>(rregullorja e programit të studimit, syllabuset, planet mësimore)</i></p> <p>Programi i studimit dhe plani mësimor kanë pësuar ndryshime përmirësuese pas liçencimit në masën 20% të aprovuara nga MASR <i>(Aneks I/2)</i>. Në programin e studimit janë shtuar lëndët e Gjenetikës, Teknikave Histopatologjike, Menaxhimit të Cilësisë në Laborator të cilat ofrojnë njohuri të përparuara në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ka një ndërthurje harmonike të koncepteve teorike me praktikën në auditor dhe praktikën profesionale. Përmes kësaj ndërthurjeje, programi zhvillon tek studentët aftësi dhe kompetenca profesionale të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e mjekësisë laboratorike. Studentët që diplomohen në këtë program studimi janë të aftë të punojnë në laboratorë klinikë, biokimikë, mikrobiologjikë. Formimi i përgjithshëm dhe aftësimi në laboratorët e institucionit krijon premisa edhe për profilizim profesional në fusha më specifike si virologjia, histopatologjia, teknikat imunologjike. <i>(syllabuset, planet mësimore, vizita në ambientet e laboratorëve)</i></p>



Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është ndërtuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimin teorik, (leksione, seminare/ushtrime) dhe praktik (laboratorë, punim projektsh, praktikë). Ngarkesa totale në auditor sipas tabelës 13 të RVB është 2200 orë nga të cilat:

- 970 orë leksione
- 395 orë seminare
- 275 orë laboratore
- 240 orë praktikë profesionale
- 200 orë kontroll i vazhdueshëm dhe praktika në auditor
- 120 orë përgatitje e temës së diplomës dhe provim formimi

Të dhënat e mësipërme kanë mospërputhje me të dhënat e llogaritura në Planin mësimor të tre viteve akademike: 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 (Aneks III/1,2,3) Referuar tabelave të planit mësimor orët totale në auditor për gjithë periudhën e studimeve janë 1884 nga të cilat:

- 780 orë leksione
- 480 orë seminare
- 360 orë laboratore
- 240 orë praktikë profesionale
- 24 orë përgatitje e temës së diplomës dhe provim formimi

Konstatohet se nuk ka diferenca në numrin e ECTS për secilën lëndë por vetëm ndryshime në ndarjen e orëve midis leksioneve, seminareve dhe laboratoreve për disa lëndë.

GVJ rekomandon plotësimin e tabelës së planit mësimor sipas modelit të tabelës 13-të RVB.

Proçesi mësimor organizohet në 39 lëndë/module. Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ të gjithë syllabuset e lëndëve/moduleve për vlerësimin e strukturës dhe përmbajtjes së tyre. Syllabuset e lëndëve janë të organizuar sipas kriterëve të përcaktuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018. Në strukturën e programit janë realizuar ndryshime për të përmbushur rekomandimet e Akreditimit të parë të programit. Kështu është bërë një shpërndarje më e mirë e ECTS në lëndë si biosiguria, infeksionet spitalore, histologjia, analiza e urinës. Në biokiminë klinike të zbatuar janë përfshirë në syllabus dhe metodat bashkëkohore si kemilumineshenca dhe konceptet e


	<p>automatizimit në laborator. Praktika profesionale realizohet në institucionet me të cilat KU Logos ka marrëveshje bashkëpunimi në dy semestrat e vitit të tretë të studimeve Bachelor.</p> <p>Detyrimet përmbyllëse kanë 6 ECTS/150 orë. Në rregulloren e programit të studimit qartësohet mënyra e diplomimit. Në dokumentacion është depozituar dhe modeli dhe suplementi i diplomës (<i>Aneks VII/14</i>)</p> <p>Personeli akademik i angazhuar për realizimin e këtij programi studimi përbëhet nga 16 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 6 PAK. 10 pedagogë efektivë janë staf i Departamentit të Shkencave Mjekësore dhe Departamentit të Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqënies Sociale. (<i>RVB-tabela 6</i>). Në program janë angazhuar dhe 2 pedagogë, staf i Departamentit të gjuhës dhe civilizimit Grek dhe një i Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë. (<i>RVB-tabela 12</i>).</p> <p><i>Ka një mospërputhje të të dhënave të paraqitura në tabelën 6 dhe 12.</i></p>
--	--

<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar tabelës 9 dhe programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laborator Mjekësor”, GVJ vlerëson se programi përmban të gjithë elementët sipas strukturës së përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Sipas planit mësimor, programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Kategoria A: Lëndë bazë 33 ECTS (18.33%); – Kategoria B: Lëndë karakterizuese 96 ECTS (53.33%); – Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 22.5 ECTS (12.5%); – Kategoria D: Lëndë plotësuese 22.5 ECTS (12.5%); – Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 6 ECTS (3.34%);
--	--

<p>Shkalla e përmbylljes së standardit</p>	<p>Nuk përmbyllet</p>	<p>Përmbyllet pjesërisht</p>	<p>Përmbyllet kryesisht</p>	<p>Përmbyllet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet kërkesat ligjore për këto njësi.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara që ofron programin e studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>KU Logos është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e institucionit dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë. Organet drejtuese dhe akademike janë senati akademik, këshilli i etikës, rektorati, dekanati, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme Autoritet drejtuese akademike janë rektori, dekanët, drejtuesit e njësisë bazë. Organet administrative janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, njësi kryesore. <i>(Aneks II/1)</i></p> <p>KU Logos ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin 2017 dhe riakredituar në nivel institucional në vitin 2021 me vendim të BA nr.58, datë 16.12.2021, për një periudhë 4 vjeçare. Programet e studimit që ofron Departamenti i Shkencave Mjekësore janë akredituar dhe janë në proces riakreditimit periodik nga institucionet përgjegjëse. Programi Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është akredituar sipas legjislacionit Shqiptar Vendim të BA nr. 50, datë 5.07.2019, me vlefshmëri maksimale prej 3 vitesh akademike. Bordi i Akreditimit ka lënë rekomandim/sugjerim për këtë program studimi, për një rishikim të planit mësimor, rekrutim të stafit të ri PAE me specializim në mjekësi laboratorike, përmirësimin e literaturës shqipe, rishikimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe furnizim më të mirë të laboratorëve me reagentë. <i>(Aneks 0/10-12)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Programet e studimit të Departamentit të Shkencave Mjekësore Bachelor dhe Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” kanë një koordinator staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion.</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për organizimin dhe realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale, përgatitjen e syllabuseve sipas një formati të miratuar dhe raporton rregullisht tek dekani i FM. <i>(Aneks VII/7)</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” realizohet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në KU Logos. Institucioni përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ka në përbërje tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Mjekësore; 2. Departamentit të Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqënies Sociale; 3. Departamenti i Informatikës së Zbatuar; <p>Infrastruktura në funksion të mësimdhënies është ristrukturuar, sallat e leksioneve dhe seminare janë të paisura me mjete didaktike, laboratorët klinik-biokimik, mikrobiologjik dhe histopatologjik janë rikonceptuar në një hapësirë të veçantë, funksionon laborator i informatikës dhe biblioteka. Në statut dhe rregullore përcaktohen qartë organet drejtuese të njësisë bazë dhe njësisë kryesore. Institucioni ka dorëzuar një dokumentacion të pasur për aktivitetin e senatit akademik, dhe organeve të tjera vendimmarrëse.</p> <p>Në shërbim të mbarëvajtjes akademike institucionale janë dhe zyra e këshillimit të studentëve, NJSBC, komisioni i etikës.</p> <p><i>(Aneks II/1, 2 Aneks I/5, RVB-tabela16)</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për vitin 2021-2022 përbëhet nga 16 pedagogë prej të cilëve 10 janë pedagogë efektivë (PAE) dhe 6 janë pedagogë me kontratë (PAK). Referuar <i>tabelës 6.3 të RVB</i>, konstatohet se në procesin akademik janë të përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 6 PAE, staf akademik i Departamentit të Shkencave Mjekësore – 4 PAE, staf akademik i Departamentit të Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqënies Sociale – 6 PAK specialist të fushave të mjekësisë dhe mjekësisë laboratorike prej të cilëve 5 kanë gradën Doktor një është Msc. <p>Stafi akademik i programit të studimit përbëhet nga pedagogë me tituj e grada me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe lider të fushave përkatëse si dhe nga asistentë lektorë me Msc në fushën e mjekësisë. Pas akreditimit të parë, institucioni ka rritur kërkesën për përfshirje në mësimdhënien e këtij programi studimi të një numri më të madh të specialistëve nga fushat e labororit apo klinikave me përfshirje të rëndësishme</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për</p>	<p>Stafi akademik i programit të studimit përbëhet nga pedagogë me tituj e grada me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe lider të fushave përkatëse si dhe nga asistentë lektorë me Msc në fushën e mjekësisë. Pas akreditimit të parë, institucioni ka rritur kërkesën për përfshirje në mësimdhënien e këtij programi studimi të një numri më të madh të specialistëve nga fushat e labororit apo klinikave me përfshirje të rëndësishme</p>

organizimin dhe strukturën akademike.

të laboratorit si hematologjia, endokrinologjia. Institucioni ka vendosur një raport të qëndrueshëm brenda kritereve ligjore midis PAE dhe PAK në favor të PAE. **(RVB-tabelat 2, 6, 12)**

Referuar nenit 25, Ligjit Nr 80/2015, *njësia bazë duhet të ketë në përbërje të saj, të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.*

Për shkak të numrit të ulët të studentëve, KU "LOGOS" ka marrë miratimin e MASR, dhe është pranuar që numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë për departamentet të jetë 5, nga të cilët dy prej tyre të kenë gradë apo titull shkencor dhe se personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë, për çdo rast, jo më pak se 70% të ngarkesës. **(Aneks No. 3 Marreveshje MAS, Reduktimi i numrit te personelit akademik ne njesine baze)**

Sipas tabelave 2 të dok **(Aneks 05. Tabelat përmbledhëse të RVB)** personeli akademik i njësise bazë përgjegjëse për programin e studimit për tre vite akademike paraqitet si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	0	2	0	2	2
Prof. Asoc.	1	0	0	0	0	0
Dr./PhD.	2	3	1	3	1	2
Msc.	1	0	2	0	1	0
Totali	5	3	5	3	4	4

Lidhur me treguesit e moshës pjesën më e madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie që kanë tituj akademikë i përkasin grup moshës relativisht mbi 66 vjeç. Lektorët me gradën Doktor i përkasin grupmoshës 36 – 55 vjeç. Në tabelat e ngarkesës mësimore të programit rezulton se mbi 70% e ngarkesës përballohet nga PAE. **(RVB-tabelat 8, 9).**

Për realizimin e programit të studimit janë angazhuar dhe 2 punonjës, personel ndihmësakademik.

KU Logos dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara janë organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet


	nënligjore në fuqi. Të dhënat numerike të paraqitura në tabelat e RVB si dhe organiogramat në statutin dhe rregulloret e institucionit e dëshmojnë qartë. Për përcaktimin e numrit të pedagogëve për çdo departament institucioni ka lidhur një marrëveshje me MASR në vitin 2019.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3


Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në KU Logos që ofron programin e studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” zotëron gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion informacionin për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadri i përgjithshëm formues i programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, plani mësimor, infrastruktura në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregullorja e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementi i diplomës. Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe syllabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi. <i>(dosja e programit të studimit)</i>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është i organizuar në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar. Programi organizohet në lëndë /module dhe praktikë mësimore në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në planin mësimor detajohet tipi i veprimtarisë formuese, ngarkesa në auditor për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore), ECTS, semestri në të cilin zhvillohet lënda, orët e studimit individual dhe orët totale. GVJ gjykon se raportet e veprimtarive

	formuese në auditor janë të arsyetuara sipas tipologjisë së lëndës. <i>(RVB- tabelat 9,10 dhe plani mësimor)</i>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ konstaton <i>(RVB-tabela 9)</i> se programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Labororë Mjekësorë” është organizuar në lëndë/module të vlerësuara me kredite (ECTS) të ndara në mënyrë proporcionale në vite. Në tre vite akademike realizohen 180 ECTS të grupuara sipas skemës së mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Kategoria A: Lëndë bazë 33 ECTS (18.33%); – Kategoria B: Lëndë karakterizuese 96 ECTS (53.33%); – Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 22.5 ECTS (12.5%); – Kategoria D: Lëndë plotësuese 22.5 ECTS (12.5%); – Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 6 ECTS (3.34%); <p>Në programin mësimor për secilën lëndë detajohet numri i ECTS totale dhe të diferencuar sipas aktiviteteve në auditor (leksione, seminare, praktika).</p> <p>Në planin mësimor vërehet një shpërndarje e harmonizuar e ECTS midis lëndëve të ndryshme duke mundësuar një formim të përgjithshëm mjekësor dhe një formim specifik në fushën e diagnozës laboratorike mjekësore.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në tabelën 10 të programit të studimit dhe në dokumentat e planit mësimor <i>(Aneks III/1, 2, 3)</i> prezantohet plani mësimor i detajuar i cili jep informacion për ndarjen e ngarkesës mësimore në vite akademike dhe semestra. Për secilën lëndë jepet informacion i detajuar për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual. Jepet gjithashtu informacion për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, ushtrime, labororë, projekte dhe praktika.</p>
	<p>Në rregulloren e programit <i>(Aneks II/3.1)</i> të studimit dhe në syllabuset e lëndëve përcaktohen kushtet e frekuentimit të mësimor (jo më pak se 75% e orëve totale për procesin mësimor që zhvillohet në auditor dhe në masën 100% për praktikat laboratorike dhe praktikën profesionale) si dhe skema e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit, neni 26 theksohet se kontrolli i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet testimit me shkrim e me gojë, detyrave të kursit, punëve në grup, praktikave profesionale, provimit të përgjithshëm</p>



	<p>përfundimtar dhe temës së diplomës. Për secilën lëndë nota përfundimtare llogaritet:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 10% nga performanca e studentit gjatë vitit; – 30% nga shlyerja e detyrimeve vjetore të lëndës (provime të ndërmjetme); – 60% vlerësimi nga provimi përfundimtar; <p>Sistemi i vlerësimit bëhet me pikë (0 – 100);</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 – 44 pikë: Nota 4 • 45 – 54 pikë: Nota 5 • 55 – 64 pikë: Nota 6 • 65 – 74 pikë: Nota 7 • 75 – 84 pikë: Nota 8 • 85 – 94 pikë: Nota 9 • Mbi 95 pikë: Nota 10
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në takimet me sekretarinë mësimore dhe studentët, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimit që vendosen me VKM dhe rregulloren e KU Logos. Institucioni nxjerr njoftime për pranimin ku përshkruhet procedura e aplikimit, testimit, shpalljes së fituesve dhe regjistrimit. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet mënyra e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ dokumentacion plotësues mbi kuotat, pranimet dhe praktikatat e transferimeve. Informacioni gjendet dhe në web site të KU Logos. <i>(Aneks II/1,2,3.1,3.2,3.3,12 Aneks VII/2.1,4.3,5 Takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë dhe për praktikën profesionale. Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Syllabuset janë të firmosura nga titullari i lëndës.</p> <p><i>Bien në sy fakti që disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë)</i></p> <p>Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe formatet e</p>



	<p>mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. <i>GVJ konstatoi se në disa prej syllabuseve mungonte përcaktimi i tipologjisë së lëndëve dhe shpërndarja e orëve në auditor nuk përputhej me të dhënat e tabelave të planit mësimor. Për këtë arsye GVJ kërkoi plotësimin e dokumentacionit. (paketat e syllabuseve)</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstaton se programet e studimit në KU Logos janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Programi Bachelor në “Teknikë e Lartë në Labororë Mjekësorë” është riorganizuar sipas kërkesave të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Hartimi dhe implementimi i planeve strategjike afatgjata në mënyrë të natyrshme kërkon përshtatje dhe harmonizim të programeve të studimit. Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në department çdo fillim viti.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nat përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Labororë Mjekësorë” përmban të gjithë elementët strukturorë të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (VKM Nr. 41/2018 dhe Udhëzimi Nr. 1 i MASR dt. 14.01.2020).</p> <p>Kohëzgjatja: 3 vite akademike – 6 semestra (2 semestra/vit)</p> <p>Kreditet: Programi vlerësohet me 180 ECTS të shpërndara në mënyrë uniforme në vite akademike. Çdo vit akademik ka 60 ECTS ose 1500 orë në total. 60% e orëve janë punë e pavarur e studentit, 40% e orëve zhvillohen në auditor. Ngarkesa mesatare javora në auditor është 20 orë.</p>

	<p>Plani mësimor mbështetet në rregulloren e programit të studimit dhe kalendarin akademik të KU Logos. <i>(Aneks I/12)</i> Viti akademik ka 30 javë (secili semester ka 15 javë). Viti akademik ka 4 sezone provimi: i dimrit-pas përfundimit të semestrit të parë, i verës-pas përfundimit të semestrit të dytë, i paradiplomimit-për studentët e vitit të tretë, i vjeshtës-pas pushimeve verore. <i>(Rregullore e programit të studimit, RVB-tabelat e planit mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Numri i lartë i orëve të praktikave profesionale(12 ECTS) i bëjnë studentët të aftë për manipulim dhe punë të pavarur në fushën e laboratorit mjekësor. Gjatë vizitës në ambientet e rinovuara të laboratorëve mjekësorë, GVJ u njoh me politikën e institucionit për t'i vënë këto hapësira në funksion të trajnimit dhe mësimdhënies edhe jashtë orareve të programit mësimor. <i>(Aneks II/3.3, plani mësimor, vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi ka një shpërndarje të llogjikshme të lëndëve në vite dhe semestra si dhe vlerësim në kredite sipas rëndësisë së syllabusit në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës në orë mësimore /ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme. Në planin mësimor vërehet një shpërndarje e harmonizuar e ECTS midis lëndëve të ndryshme duke mundësuar një formim të përgjithshëm mjekësor (anatomie normale, fiziologji, fizpatologji) formim shkencor (fizikë optike, kimi organike, biologji, histologji, gjenetikë, biologji molekulare, biostatistikë etj) dhe një formim specifik në fushën e diagnozës laboratorike mjekësore (biokimi klinike, hematologji, mikrobiologji, imunologji klinike, teknika histopatologjike etj). Në program janë përfshirë dhe lëndë të një formimit të përgjithshëm organizativ dhe të komunikimit (gjuhë e huaj, psikologji, legjislacion dhe deontologji, menaxhim dhe kontroll i cilësisë) të cilat e aftësojnë studentin edhe në fushën e organizimit, kontrollit dhe dokumentimit të aktivitetit profesional. <i>(tabelat e planit mësimor, paketa e syllabuseve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është strukturuar dhe përmirësuar bazuar në eksperiencën e gjatë të ofrimit të këtij programi nga</p>

<p>kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>KU Logos si dhe mbështetur në modelet dhe praktikat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë. Struktura e programit, emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane. (Tabelat e planit mësimor)</p> <p>Në takimin me zyrën e projekteve GVJ u informua se KU Logos synon aktivizimin e projekteve- marrëveshje për mbështetje të mësimdhënies dhe forcim të kapaciteteve (Dokumentacioni i marrëveshjeve Erasmus dhe me universitetet e Greqisë)</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Strukturimi i programit (Plani mësimor), unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkurrues në tregun e punës publik e privat, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Në dokumentat mbi politikën e marketingut dhe në raportin analitik për të diplomuarit referohet se mbi 90% e të diplomuarve janë të punësuar. Në takimin me studentët u theksua se në vitet e fundit është shtuar oferta e punës me kontribut dhe të institucioneve partnere në kryerjen e praktikës profesionale. (takimet në institucion). Sipas të dhënave të pasqyruara në RVB (RVB-Tabela 23) rreth 75% e të diplomuarve në tre vitet e fundit janë punësuar në profesion.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Institucioni inkurajon përditësimin e vazhdueshëm të programit të lëndëve me literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Në analizën e paraqitur në RVB evidentohet se në tre vitet e fundit si rezultat i pandemisë ka patur më pak përpjekje për rinovim të literaturës. Megjithatë një pjesë e pedagogëve po synojnë dhe realizojnë hartimin e teksteve universitare për studentët e KU Logos e më gjerë. Në takimin me stafin akademik Dr. S B, na prezantoi botimin e tij për Lëndën e biokimisë Klinike të këtij programi.</p> <p>Në syllabuse është punuar për përditësimin e literaturës së huaj e ndihmuar dhe nga rikonceptimi i funksionimit të bibliotekës.</p> <p>Mbështetur në literaturë bashkëkohore, pedagogët e këtij programi studimi pregatisin leksione dhe materiale didaktike të shkruara për studentët. Këto materiale janë përdorur me eficiencë veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë dhe mësimin on line. (paketa e syllabuseve, takimet në institucion)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të</p>	<p>Në nenin 5 të rregullores së programit të studimit citohen objektivat formuese që mund të përmbliidhen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfitimi i njohurive bazë teorike në fushën e zhvillimit të programit;


<p>synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e specialistëve në fushat e laboratorit klinik, biokimik, mikrobiologjik dhe histopatologjik; • Përgatitja e specialistëve të aftë të përdorin teknologjinë bashkëkohore në laboratorët mjekësorë; • Përgatitja e studentëve të aftë për të vazhduar studimet universitare të ciklit të dytë; <p>Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. Strukturimi i programit krijon mundësi për transferim të studimeve dhe mobilitet. <i>(Aneks II/3.3 Plani mësimor)</i></p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është strukturuar dhe përmirësuar nga specialist të spikatur të fushës së mjekësisë laboratorike. Përmbajtja e programit të studimit iu mundëson studentëve vijimin e studimeve në ciklin e dytë. Departamenti i Shkencave Mjekësore ofron dhe programin e studimit Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë duke krijuar mundësi për vazhdimësi në përgatitjen dhe ngritjen profesionale brenda institucionit. Në takimet në institucion u informuam se studentët që mbarojnë këtë program studimi preferojnë të punësohen fillimisht dhe më pas rikthehen për studimet e ciklit të dytë. Rreth 50% e studentëve të ciklit të dytë janë student që kanë kryer dhe ciklin e parë në këtë institucion. Praktika profesionale është një mundësi për njohjen e studentit me realitetin e profesionit dhe përfitimin direkt nga ofertat e tregut të punës.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Për përmirësimin e programeve të studimit dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës strukturat përgjegjëse konsultohen me bashkëpunëtorë dhe partnerë. Analizat e thelluara të tregut të punës, pjesmarrja në panairë dhe workshop ndihmojnë për të forcuar këmbimin e informacionit dhe urat e bashkëpunimit të institucionit me laboratorë partnerë. Institucioni ka interes të njihet me të rejtat në fushën e profesionit për t’i pasqyruar në programin e studimit duke bërë që student të marrë njohuri të përditësuara dhe të përshtatet në përfundim të studimeve me kërkesat specifike të tregut të punës. <i>(Aneks VII/3,5,9.1,9.2 III/5.1,5.2)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.5

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																							
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik PAE dhe PAK që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përmbush kërkesat e ligjit të arsimit të lartë (ligji 80/2015) dhe VKM 418 datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëvetë tyre”. Ata kanë të paktën diplomë të ciklit të dytë të studimeve (Msc). Titullarët e moduleve janë me titull Prof. Dr., Prof. Assoc. ose me gradën Doktor.</p>																																																							
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik me tituj e grada që angazhohet në këtë program studimi përbëhet nga personalitete të spikatur në fushat përkatëse dhe me eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. <i>(CV e personelit akademik)</i></p> <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”, bazuar në tabelat 6.1 – 6.3 të RVB është:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2021 – 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 6 PAK (62.5 % / 37.5 %); 2. Për vitin akademik 2020 – 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 6 PAK (62.5 % / 37.5 %); 3. Për vitin akademik 2019 – 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 19 pedagogë nga të cilët 8 PAE dhe 11 PAK (43 % / 57 %): 																																																							
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2019 - 2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>3</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr në proces)</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>10</td> <td>6</td> <td>10</td> <td>6</td> <td>8</td> <td>11</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	2	-	3	-	3	3	Prof.As.Dr	2	-	2	-	1	0	Dr/PhD	3	5	2	5	2	6	Msc (Dr në proces)	2	0	2	-	2	1	Msc	1	1	1	1	-	1	Në total	10	6	10	6	8	11
Tituj/grada	2021 - 2022		2020 - 2021		2019 - 2020																																																			
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																																		
Prof.Dr	2	-	3	-	3	3																																																		
Prof.As.Dr	2	-	2	-	1	0																																																		
Dr/PhD	3	5	2	5	2	6																																																		
Msc (Dr në proces)	2	0	2	-	2	1																																																		
Msc	1	1	1	1	-	1																																																		
Në total	10	6	10	6	8	11																																																		


	<p>Ndërkohë pasi analizuam informacionin e dhënë në tabelat 12.1-12.3 të RVB, për ngarkesën mësimore javore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2019-2020 63.5 % PAE / 36.5 % PAK; • 2020-2021 73% PAE / 27 % PAK; • 2021-2022 74.4 % PAE / 25.6 % PAK; <p>Personeli akademik që është angazhuar në këtë program studimi janë staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradën shkencore Doktor apo Msc.</p> <p>Kategorizimi i pedagogëve në Lektorë dhe Asistent Lektorë bazohet në kërkesat e Ligjit në fuqi. Lektorët janë me titull Prof/Prof. Assoc, ose gradë Doktor; Asistent Lektorët kanë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, Master të Shkencave. Në takimin me drejtuesit e programit të studimit u informuam për përpjekjet dhe vështirësitë e institucionit për të rekrutuar si PAE staf të ri akademik specialist në fushën e laboratorit mjekësor.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar për realizimin e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Infermieristikë për vitet akademike 2019-2022 zotërojnë tituj akademikë, gradën shkencorë doktorë, ose diplomë Msc. Anëtarët e stafit akademik janë përzgjedhur me eksperiencë në mësimdhënie si dhe kompetencë profesionale dhe akademike, që përputhet me lëndët që ata zhvillojnë në këtë program mësimor. <i>(CV e personelit akademik)</i></p> <p>Gjatë shqyrtimit të tabelave të detajuara të planit mësimor, GVJ konstaton një shpërndarje harmonike të ngarkesës të bazuar në ekspertizën profesionale të pedagogëve dhe një numër orësh në auditor të realizuar për këtë program që varion nga 30-300 orë. <i>(RVB-tabela 4)</i>. Institucioni ruan një raport të mirë PAE/PAK në mësimdhënie. 74.4% e programit mësimor aktualisht mbulohe nga pedagogët efektivë duke krijuar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të mirë për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe</p>	<p>Për zhvillimin e praktikës profesionale, komponent i rëndësishëm i formimit në këtë program studimi institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me partnerë laboratorë spitalorë dhe jospitalorë, publikë dhe privatë. Sipas marrëveshjeve studentët në këto struktura punojnë nën mbikqyrjen e një punonjësi të kualifikuar e instruktuar. Praktika ndiqet dhe nga persona përgjegjës të angazhuar nga institucioni. Në takimin me drejtuesit e institucionit dhe stafin</p>

mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	akademik u informuam që janë shtuar marrëveshjet me laboratorë që kanë teknologji bashkëkohore dhe i ofrojnë studentit mundësi maksimale për përfitim në praktikë. Në institucionet ku realizojnë praktikën studentët mund të realizojnë dhe pjesën praktike të temës së diplomës nën udhëheqjen e pedagogëve PAE ose PAK. Në këto institucione por dhe në laboratorët e KU Logos studentët kanë realizuar punime të udhëhequr nga pedagogët të cilat janë prezantuar në konferencat studentore të zhvilluara nga institucioni. <i>(Aneks VIII/1, Aneks VII/9.2,17 Aneks V/4)</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Për realizimin e orëve mësimore laboratorike institucioni ka angazhuar staf ndihmës akademik teknik i cili përgjigjet për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, organizimin dhe zhvillimin e praktikës mësimore laboratorike duke iu asistuar studentëve dhe pedagogëve. Konkretisht stafi ndihmës akademik i programit të studimit përbëhet nga 2 (dy) anëtarë të diplomuar në Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë dhe me eksperiencë pune. Një staf ndihmës asiston punën në laboratorin mikrobiologjik dhe histopatologjik, një staf ndihmës asiston punën në laboratorin biokimik dhe hematologjik. <i>(Aneks IV/12)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>KU Logos ka hartuar rregullore për funksionimin e institucionit dhe programit të studimit të miratura nga titullari i institucionit. Këto rregullore përcaktojnë elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive. <i>(Aneks II/1, 2, 3.1, 3.2, 3.3)</i></p> <p>GVJ në takimin me stafin akademik konstatoi se në programin e studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online. Për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë përmes platformave <i>online</i> institucioni iu ka siguruar studentëve dhe pedagogëve mbështetjen përmes trajnimit dhe përpilimit të rregulloreve për realizimin e praktikave dhe laboratorëve on line, për realizimin e provimeve online dhe për politikën e vlerësimit në distancë, për përdorimin e platformave dixhitale. <i>(Aneks I/7,8, I/15,XI/5,VII/11.1)</i></p> <p>Në praktikat laboratorike në lëndët e mikrobiologjisë dhe histopatologjisë pedagogët kanë krijuar skedarë me materiale mikroskopike të cilat iu shërbejnë studentëve për aftësim praktik. <i>(vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka krijuar dhe ka në funksionim NJSBC që kryen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrativ. Parimet dhe politikat e cilësisë përcaktohen në statut dhe në rregulloret e institucionit. NJSBC funksionon bazuar në rregullore dhe përdor një paketë instrumentash specifike për monitorimi dhe kontrollin e cilësisë. NJSBC analizon informacionin e mbledhur përmes pyetsorëve dhe metodave të tjera, përpilon raporte periodike të cilat i vendos në dispozicion të institucionit në funksion të përmirësimit të procesit mësimdhënës. Në veprimtarinë e tij NJSBC ka autonomi operative. Instrumentat kryesorë të vlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – pyetsorët e studentëve për lëndët dhe pedagogët; – pyetsorët e studentëve për njësinë bazë; – formularët e vetëvlersimit të stafit;



	<ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi i performancës nga përgjegjësi i departamentit për stafin; - vlerësimi i performancës nga dekani për përgjegjësat e departamentit; (<i>Aneks VI/1,2,4,5,7,8 takimet në institucion</i>)
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni në mënyrë periodike çdo vit vlerëson metodat e mësimdhënies nëpërmjet realizimit të plotësimit të pyetësorit të vlerësimit nga studentët. Studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik, problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik si dhe logjistikën në funksion të programit të studimit. NJSBC ka ndërtuar pyetsorë për aktivitetin në auditor dhe pyetsorë të vecantë për praktikën.</p> <p>Në takimin me NJSBC u informuam se veç pyetsorëve periodikë, studentët vlerësojnë programin dhe procesin akademik edhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta për të mundësuar trajtimin e ankimimeve në raport me procesin. GVJ u informua për procedurën e ndjekur në rastin e një ankimimi për shpjegimin e paqartë në auditor. Edhe në periudhën e pandemisë, studentëve iu është mundësuar vlerësimi periodik përmes platformave online. NJSBC raportoi që në këtë periudhë, numri i studentëve të angazhuar në plotësimin e pyetsorëve ishte më i vogël. (<i>takimet në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC përgatit raportin përfundimtar mbi vlerësimin e bërë nga studentët për aktivitetin akademik, kërkimor shkencor dhe shërbimet e ofruara nga institucioni dhe ia vë në dispozicion rektorit dhe senatit akademik. Rezultatet për vlerësimin e dhënë nga studentët bëhen publike për të gjithë stafin akademik në formë të personalizuar. Rezultatet e përfuara nga këto vlerësime shërbejnë si bazë për rekomandime dhe përmirësime të mundëshme të metodave të mësimdhënies. Në takimin me NJSBC, GVJ u informua se rekomandimet për përmirësim të metodave të mësimdhënies kanë qenë një shtysë për institucionin për të realizuar marrëveshje mobiliteti në universitetet partnere me fokus metodat e mësimdhënies. (<i>Raportet e NJSBC Aneks VI/6.1,6.2,6.3,6.4,6.5,6.6,6.7, takimet në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e</p>	<p>Rezultatet dhe informacionet e marra nga sondazhet i shërbejnë përmirësimit të punës në institucion, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit të metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve. Për promovimin e shembujve dhe praktikave më të mira institucioni përdor mënyra të ndryshme si mbështetje për pjesëmarrje në trainime</p>

mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	apo konferenca shkencore, botime të punimeve të tyre në revista shkencore, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																													
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor institucioni/programi i studimit ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, përgatitjen e detyrave të kursit, tema diplome, punë kërkimore në laborator, si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe workshop. <i>(rregullore e programit të studimit, dokumentacioni i konferencave studentore)</i></p> <p>Në organizimin e studimeve një vend të rëndësishëm ze dhe puna e pavarur e studentit (rreth 60% e orëve totale).</p> <p>Tabela e mëposhtme paraqet informacion më të detajuar të përmbledhur nga tabela e planit mësimor në RVB. Diploma në total ka 150 orë prej të cilave 30 janë atashuar në rubrikën seminare :</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Bsc në TLLM</th> <th>Viti I</th> <th>Viti II</th> <th>Viti III</th> <th>Në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Në auditor</td> <td style="text-align: center;">600</td> <td style="text-align: center;">600</td> <td style="text-align: center;">810</td> <td style="text-align: center;">2010</td> </tr> <tr> <td>- Leksione</td> <td style="text-align: center;">380</td> <td style="text-align: center;">330</td> <td style="text-align: center;">245</td> <td style="text-align: center;">955</td> </tr> <tr> <td>- Seminare</td> <td style="text-align: center;">170</td> <td style="text-align: center;">125</td> <td style="text-align: center;">125</td> <td style="text-align: center;">420</td> </tr> <tr> <td>- Laboratore</td> <td style="text-align: center;">50</td> <td style="text-align: center;">145</td> <td style="text-align: center;">80</td> <td style="text-align: center;">275</td> </tr> <tr> <td>- Praktika profesionale</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">240</td> <td style="text-align: center;">240</td> </tr> <tr> <td>- Diploma</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">-</td> <td style="text-align: center;">120</td> <td style="text-align: center;">120</td> </tr> <tr> <td>Punë e pavarur e studentit</td> <td style="text-align: center;">900</td> <td style="text-align: center;">900</td> <td style="text-align: center;">900</td> <td style="text-align: center;">2700</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td style="text-align: center;">1500</td> <td style="text-align: center;">1500</td> <td style="text-align: center;">1710</td> <td style="text-align: center;">4710</td> </tr> </tbody> </table>	Bsc në TLLM	Viti I	Viti II	Viti III	Në total	Në auditor	600	600	810	2010	- Leksione	380	330	245	955	- Seminare	170	125	125	420	- Laboratore	50	145	80	275	- Praktika profesionale	-	-	240	240	- Diploma	-	-	120	120	Punë e pavarur e studentit	900	900	900	2700	Gjithsej	1500	1500	1710	4710
Bsc në TLLM	Viti I	Viti II	Viti III	Në total																																										
Në auditor	600	600	810	2010																																										
- Leksione	380	330	245	955																																										
- Seminare	170	125	125	420																																										
- Laboratore	50	145	80	275																																										
- Praktika profesionale	-	-	240	240																																										
- Diploma	-	-	120	120																																										
Punë e pavarur e studentit	900	900	900	2700																																										
Gjithsej	1500	1500	1710	4710																																										
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të</p>	<p>Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në ppt., biseda interaktive me studentët, demonstrimi i</p>																																													

Alto *M. M. M.*

<p>respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>procedurave praktike laboratorike, ushtrime me raste klinike, demonstrime në mikroskop. Studentët punojnë në grupe të vogla në laborator. Në orët e mikroskopisë pedagogu orienton studentët duke u ndihmuar dhe nga materialet didaktike të vendosura në formë panelesh në muret e laboratorëve. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo laboratorëve mësimore. Në takimin me stafin akademik GVJ konstatoi se pedagogu ka liri akademike në zhvillimin e orës së leksionit; stimulohet mësimi interaktiv që kombinon shpjegimin me pyetjet për subjektin e shpjeguar apo ushtrimet në lidhje me të. (takimi dhe vizita në institucion)</p> <p>Një sfidë për programin e studimit ka qenë praktika laboratorike online. Departamenti në bashkëpunim me IT vendosi në funksionim platformat on line përmes të cilave u kryen demonstrime laboratorike në kohe reale si dhe u shpërndanë temat e praktikës laboratorike në formën e videove ilustruese. (Aneks XI/4)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët mjekësorë biokimik-klinik, mikrobiologjik, histopatologjik si dhe laboratorit i informatikës. Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. (Aneks I/7,8,XI/4,5 takimet dhe vizita në institucion dokumentacioni për mobilitetin e pedagogëve)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë mjekësorë apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve etj. (CV e stafit akademik)</p> <p>Kjo reflektohet dhe në vlerësimin periodik që studentët i bëjnë mësimdhënies dhe stafit akademik (vlerësim pozitiv mbi 90%) të pasqyruar në raportet e NJSBC. Personeli akademik është aftësuar dhe ka realizuar me sukses dhe metodat e punës on linë sipas tematikave dhe profilit. (Aneks XI/5)</p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit, takimet mujore të studentëve me koordinatoren e programit. Rezultatet e raportuara nga NJSBC në raportin vjetor tregojnë se studentët e gjejnë tërheqës procesin mësimor dhe sfidues detyrat e pedagogëve. Në 90% shpjegimi gjykohet i qartë dhe reflektohet përdorimi i metodave inovative. Në orën e mësimi ka bashkëveprim interaktiv pedagog-student. <i>(Aneks VI/5)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie si me anë të projektorëve, prezantime PPT, metoda interaktive, përdorimi i apo metodat online duke shfrytëzuar platformat që janë të përdorshme si për studentët dhe pedagogët, përfshirjen e tyre në trainime dhe konferenca shkencore, apo projekte së bashku me pedagogët e tyre. Në laboratorët e Departamentit është krijuar nga pedagogët një kartotekë e rasteve klinike të cilat përdoren për aftësimin profesional të studentit sidomos në fushën e mikroskopisë laboratorike. <i>(vizita dhe takimet në institucion)</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Studentët inkurajohen për punë të pavarur në ambientet e laboratorit dhe në laboratorët partnerë për të krijuar sensin e autonomisë dhe forcuar besimin në aftësitë dhe gjykimin profesional. Gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale apo punimit të temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët e tyre si në zgjedhjen e temës ashtu dhe në hartimin e saj. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellë pedagog-student që reflektohet dhe në realizimin e konferencave studentore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Null përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe</p>	<p>KU Logos ka siguruar hapësirat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, të pajisura me sistem kondicionimi dhe</p>

Alto
Enxhem

<p>cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>ndriçimin e duhur. Hapësira e dedikuar për studentët përbëhet nga sallat e leksioneve, klasat e seminareve, sallat për praktika dhe aktivitete promovuese, laboratorët, salla e internetit dhe bibliotekës, mjediset ndihmëse/çlodhëse dhe nyjet higjenosanitare. Institucioni përmbush me tejkalim kriteret ligjore për hapësirat e dedikuara për studentët (rreth 10m²/student). Hapësirë e mjaftueshme sigurohet dhe për stafin akademik, ndihmw akademik dhe administratën. Institucioni ka rinovuar dhe zgjeruar hapësirat pritëse duke fituar një pamje më dinjitoze. (RVB-tabela 16, vizita në ambientet e institucionit)</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Në KU Logos ambientet ku zhvillohet procesi mësimor kanë infrastrukturën fizike dhe logjistikën e nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë për zhvillimin e mësimit. Salla për aktivitetet promovuese është e paisur me ekrane dhe njësinë e përkthimit duke siguruar mundësi jo vetëm për zhvillim të procesit mësimor por dhe për zhvillimin e aktiviteteve shkencore me prani të lektorëve shqiptarë dhe të huaj. Laboratorët e biokimisë klinike, mikrobiologjisë dhe histopatologjisë janë rikonceptuar si pjesë integrale e një njësie qendrore (siç është tendenca e sotme në tregun e punës). Ato janë mirë të paisur për realizimin e programit mësimor për të nxitur punën e pavarur të studentit, dhe aftësimin praktik të tyre por dhe për të realizuar projekte shkencore nga studentët dhe pedagogët. Të gjitha këto ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. (vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve burime të ndryshme informacioni si internet, referenca për literaturë në gjuhë të huaj në formë elektronike ku ata mund të gjenë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, leksionet, librat si dhe literaturën e nevojshme në gjuhën italiane dhe gjuhën angleze. Institucioni ka investuar në sistemin online TIMS për të mundësuar mësimin virtual. Personeli akademik dhe studentët janë paisur me manuale instruktuese për përdorimin e platformave online. Institucioni siguron mbulimin me sinjal interneti në hapësirat e tij. (Aneks XI/4,5,5.1 vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe</p>	<p>Literatura bazë për programin e studimit gjëndet në bibliotekën e Universitetit e printuar dhe në format elektronik. Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe që është gjuha e programit të studimit apo në gjuhë të tjera të huaja që i përgjigjet temave të programit mësimor. Pedagogët ofrojnë</p>

<p>njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>dhe leksione të përgatitura prej tyre në formë elektronike. Në fillim të çdo viti akademik Departamenti miraton literaturën e përditësuar për syllabuset dhe informon Bibliotekën e cila bën parashikimet buxhetore për blerje literature. <i>(Aneks XI/7.7)</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni ka në funksion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën. Gjatë vizitës në bibliotekë dhe takimet me stafin akademik GVJ konstatoi se në bibliotekën e KU Logos gjëndet një numër i mjaftueshëm librash në gjuhën shqipe dhe të huaj si për studentët dhe pedagogët. Në blerjen e librave institucioni merr parasysh kërkesat dhe nevojat apo sugjerimet e studentëve dhe stafit akademik. Biblioteka ka 23000 njësi materiale të kataloguara sipas fushave të studimit. Në 5 vitet e fundit fondi i librave për Departamentin e Shkencave Mjekësore është shtuar me 154 tituj nga të cilët 137 në gjuhën shqipe. <i>(Aneks XI/7.1-7.7)</i></p> <p>Biblioteka është rinovuar me një koncept bashkëkohor ndriçimi dhe ajrimi. Ajo ka infrastrukturë të duhur dhe zotëron 40 poste leximi dhe 18 poste me kompjutera. Ambienti është i mbuluar me wireles. Biblioteka përditësohet vazhdimisht me literaturën e fundit. Biblioteka është dixhitalizuar dhe vendos në dispozicion të përdoruesve katalogun elektronik. <i>(vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni i siguron studentëve dhe pedagogëve mundësi aksesimi në librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë si dhe gjetjen e burimeve online të informacionit të gjetura nga vetë studentët apo stafi akademik. Studentët dhe personeli akademik kanë akses të dedikuar në faqen eeb të bibliotekës ku mund të konsultojnë katalogun elektronik dhe të marrin informacionet e nevojshme. Burime ndërkombëtare elektronike për libra apo artikuj shkencorë të siguruar nga universiteti përmes marrëveshjeve me universitete partnere janë EBSCO dhe JSTOR. Për mënyrën e përdorimit të sistemit online, institucioni ka dhe udhëzuesit përkatës në funksion të studentëve dhe stafit akademik. <i>(Aneks XI/7.1-7.7 vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura laboratorike e programit të studimit përbëhet nga tre laboratorë të integruar: laborator i biokimik-hematologjik, laborator i mikrobiologjik dhe laborator i histopatologjik. Laboratorët mirëmbahen nga stafi ndihmës. Studentët punojnë në laborator nën mbikqyrjen e pedagogëve. Laboratorët ofrojnë teknologji dhe hapësira të përshtatshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit dhe studimeve</p>


	specifike. Gjatë vizitës në ambientet e laboratorit ne takuam studentë që e frekuentonin laboratorin edhe jashtë orëve të mësimi. Plani strategjik parashikon fuqizimin e teknologjisë laboratorike në fushën e imunologjisë dhe biologjisë molekulare. <i>(takimet në institucion)</i>			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nga takimet me stafin, studentët, sekretarinë dhe burimet njerëzore, rezultoi se institucioni ka në përdorim platformën online EduPage. Institucioni ka një sistem të menaxhimit të informacionit. Pedagogët dhe studentët kanë llogaritë e tyre në sistem. Sistemi mundëson komunikimin interaktiv pedagog-student dhe për çdo lëndë të programit të studimit <i>(RVB-tabela17, takimet në institucion)</i>			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët kanë hapësirat vetjake të dedikuara në sistemet e komunikimit online. Personeli akademik e shfrytëzon platformën për të ngarkuar materiale mësimore didaktike, që mund të shfrytëzohen nga studentët përmes komunikimit interaktiv.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temave të diplomës. Temat zgjidhen të lidhura me problematikat aktuale të sistemit laboratorik shëndetësor, të jenë në funksion të përgatitjes profesionale dhe të përshtatura me mundësitë aktuale për realizimin e pjesës eksperimentale të tyre. Studentët asistohen nga pedagogët për zgjedhjen dhe realizimin e temës së diplomës. Në dy vitet e pandemisë diplomimi u realizua me provim për vetë kushtet e krijuara. <i>(Aneksi VII/17, takimet në institucion)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të	Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të KU Logos / Fakulteteve / departamenteve / programeve të studimit, të cilat janë në funksion të organizimit të mësimdhënies në programe të ndryshme studimi. Njësia

<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>kryesore që asiston në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor është NJSBC. Kjo njësi harton plan pune bazuar në rregulloret e funksionimit të saj. NJSBC-ja harton raporte vjetore që janë detyrim institucional. Raportet e NJSBC shërbejnë si shtysë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. <i>(Aneks II/1,2,3,8,11)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara është njësi përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programit të mësimimit në Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. Departamenti në bashkëpunim me strukturat e tjera përcakton nevojat për staf akademik, propozon kriteret për përzgjedhjen e tyre në procesin mësimor, propozon shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas ekspertizës dhe kompetencës profesionale, miraton syllabuset, monitoron realizimin e procesit mësimor sipas plani të miratuar, vlerëson procesin e mësimdhënies etj. Departamenti realizon analiza vjetore të punës mësimore-shkencore dhe të përfshirjes së studentëve në proces. Analiza zhvillohen dhe në nivel fakulteti. Në dokumentacion ka evidenca të këtyre aktiviteteve. <i>(Aneks II/2, II/24.2, V/2.3)</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Njësia kryesore ku zhvillohet ky program studimi mbështet dhe nxit pedagogët të përdorin metodave inovative dhe alternative në procesin e mësimdhënies. Institucioni ka mbështetur fort aplikimin e metodave të mësimdhënies online përmes trajnimit të stafit akademik si dhe përmes investimit në këto platforma. <i>(RVB, vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është personel i kualifikuar dhe trajnuar në fushat specifike të ekspertizës profesionale. Personeli akademik i këtij programi studimi ndjek kurse trajnimi me afate të ndryshme sipas nevojave dhe interesave specifike për aftësim në mësimdhënie. Anëtarët e stafit akademik përfshihen në aktivitete individuale si botimet dhe pjesmarrja në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit <i>(RVB-tabela 19,20)</i> Të dhënat e kualifikimit periodik pasqyrohen dhe në raportin vjetor të njësisë bazë dhe njësisë kryesore. <i>(Aneks IV/5)</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe</p>	<p>KU Logos nuk ka një njësi përgjegjëse për trajnimin e personelit akademik. Në takimet në institucion dhe në RVB u theksua se NJSBC është njësi përgjegjëse që koordinon veprimtaritë trajnuese sipas nevojave të identifikuara në</p>



<p>implementimit të metodave të reja.</p>	<p>raportet analitike të kësaj njësie. KU Logos ka mbështetur fuqimisht trajnimin e stafit akademik për petodat e reja të mësimdhënies në universitetet partnere përmes aplikimit me programin Erasmus+ dhe programe të tjera të ngjashme. Institucioni ka dhënë mbështetje financiare për botime dhe pjesmarrje në konferenca internacionale për anëtarë të stafit akademik. <i>(Aneks IX/5.1,5.2)</i></p> <p>GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, realizimit të konferencave ndërkombëtare të përbashkëta me universitet dhe institucione Italiane, realizimin e botimeve në buletin shkencorë të institucionit, pjesëmarrjen në projekte kërkimore shkencore.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Në rregulloret e institucionit janë përcaktuar qartë detyrat e personelit akademik dhe ndihmës akademik për zbatimin e programeve të studimit. Në zhvillimin e procesit mësimor, duke u mbështetur në lirinë akademike pedagogu teston metoda të ndryshme mësimdhënie sipas lëndëve të veçanta. Metodrat e IT mundësojnë përdorimin e mjeteve ndihmëse që lejojnë bashkëpunimin student pedagog si simulimet e praktikave laboratorike, leksione, seminare takime me anë të platformave IT online si zoom, meeting, uebinar. Eksperiencat e reja diskutohen dhe rezultatet e tyre paraqiten në department duke shpërndarë eksperiencën me kolegët. Këto i shërbejnë zbatimit të metodave të reja dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. <i>(takimet në institucion, Aneks II/2)</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies njësia bazë mbështet eksperimentin dhe futjen e metodave të reja inovative në realizimin e procesit mësimor. Me futjen e sistemeve kompjuterike njësitë bazë bashkërendojnë më njëri tjetrin në organizmin e trainimeve me stafin ndihmës akademik të angazhuar në realizimin e procesit mësimor dhe veprimtarinë kërkuese për përmirësimin e vazhdueshëm të metodave didaktike. Rezultatet raportohen dhe pasqyrohen në analizat vjetore të njësisë bazë dhe njësisë kryesore. <i>(takimet në institucion, Aneks II/24, 24.2)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktohen në mënyrë specifike të gjitha rregullat dhe modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të Fakultetit, të programit si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Pikët e llogaritura sipas tabelës 15 konvertohen në nota. Nota 10 merret me mbi 95 pikë. Nën 44 pikë, studenti vlerësohet me notë 4-jokalues. <i>(Rregullore e programit të studimit, paketa e syllabuseve, RVB-tabela15)</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, provimi diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. <i>(Rregullore e programit të studimit, paketa e syllabuseve, RVB)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet qartë sistemi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale. Në nenin 26 të kësaj rregulloreje theksohet se kontrolli i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim dhe me gojë, detyrave të kursit, punës në grup, praktikave profesionale dhe provimit përfundimtar. Në tabelën 15 të RVB përcaktohet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 5% e pikëve të notës fitohen nga ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive; • 5% e pikëve të notës fitohen nga plotësimi i detyrimeve (laborator, detyra kursi); • 30% e pikëve të notës fitohen nga testimet e kryer gjatë vitit; • 60% e pikëve të notës fitohen nga provimi përfundimtar; <p>(Aneks II/3.3, RVB-tabela 15)</p> <p>Lëndët në fund të semestrit shlyhen me test ose provim sipas përcaktimit në planin mësimor. Vlerësimi i dijeve bëhet në përputhje me planin e studimit dhe zhvillohet në katër sezone: i dimrit-pas përfundimit të semestrit të parë, i verës-pas përfundimit të semestrit të dytë, i paradiplomimit-për studentët e vitit të tretë, i vjeshtës-pas pushimeve verore.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Me urdhërin e rektorit Nr.10, datë 22.05.2020 “Për përdorimin e platformës dixhitale për mësimin në distancë” KU Logos vë në zbatim në mënyrë të organizuar dhe koordinuar sistemet elektronike për mësimin online. Platformat e përdorura janë Edupage, Google Classroom, NEO LMS, Skype. Për realizimin e mësimin on line u ngritë dy ekiye, një ekip për menaxhimin akademik të mësimin në distancë, një ekip për administrimin teknik të mësimin në distancë.</p> <p>Po në vitin 2020 Senati akademik pa publikuar dokumentin për “Politikën e vlerësimit në distancë. Në këtë dokument prezantohen një seri udhëzimesh për pedagogët për format e vlerësimit në distancë. Pedagogët janë instruktuar nga departamenti për kontrollin e nivelit të ngjashmërisë së punimeve duke përdorur platformat online. (Aneks XI/14, I/7, I/8)</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2</p>	<p>Komisioni i vlerësimit të provimit përbëhet së paku nga dy pedagogë ku njëri është titullari i lëndës. Në përfundim të provimit, pedagogu i lëndës dorëzon fletën e provimit të plotësuar në sekretari. Fleta e provimit nuk duhet të ketë korrigjime. Ajo përbën dokumentin zyrtar që vërteton dhënien e provimit dhe rezultatin e studentit. (Aneks II/3.3)</p>




anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar dhe procesi i provimit bazohet në rregulloren e programit e studimit. Kur provimi bëhet me shkrim procesi është anonim me sekretim. <i>(Aneks XI/14)</i> Sdudentët para provimit paisen me një kod që përdoret për çkodimin e fletës së provimit pas korigjimit të saj dhe komunikimin e rezultateve të studentët.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Në rregullore përcaktohen qartë detyrimet që lidhen jo vetëm me ndjekjen e procesit mësimor por dhe me numrin e ECTSve teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që student duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi. Studenti paraqitet në provim me dokument identifikues dhe çdo objekt që ka me vete vendoset në një vënd të caktuar nga organizatorët. Në rregulloret e institucionit njihet e drejta e studentit për t'u njohur me rezultatin e provimit në prani të lektorit të kursit. GVJ inspektoi dosje provimesh në sekretarinë mësimore dhe i gjeti të rregullta plotësisht.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Njësitë përgjegjëse kanë krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara parashikon masa disiplinore (nga vërejtje me shkrim në përjashtim) për studentët që kapen duke kopjuar. Në rastin e provimeve të zhvilluara on line parashikohet përdorimi i teknologjisë për verifikimin e origjinalitetit. Në RVB theksohet se institucioni angazhohet seriozisht në ndershmerinë akademike. <i>(Aneks II/10, 3)</i>
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Në rregulloren e KU Logos përcaktohet afati 5 ditë për shpalljen e rezultateve të provimit. <i>(Aneks II/2)</i> NJSBC monitoron mbarëvajtjen e procesit të provimit dhe përpilon raporte për këtë proces. <i>(Aneks VI/6.7)</i> Detyrimet e përcaktuara në kodin e etikës për personelin akademik bëjnë të detyrueshëm vlerësimin e bazuar në meritë. Në RVB, mungesa e ankimeve për rezultatet në provime konsiderohet tregues i një vlerësimi të suksesshëm në bazë merite.

<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit. <i>(Aneks II/2, 3.3)</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Ankimimi për rezultatin e provimit bëhet jo më vonë se një javë nga publikimi i rezultateve. Rregullorja e programit të studimit parashikon një procedurë të qartë për ankimimin e rezultatit. Ankimimi shqyrtohet fillimisht nga pedagogu i lëndës. Departamenti ngre një komision të përbërë nga të paktën 2 anëtarë staf akademik me njohuri në fushën përkatëse. Vendimi i komisionit vlerësues është i formës së prerë. Procedura dokumentohet dhe arkivohet. <i>(Aneks II/3.3)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Së përbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përcakton objektiva të qartë profesionale për formimin e specialistëve polivalentë në fushën e laboratorëve mjekësorë. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim bazë në lëndët shkencore dhe paraklinike, si dhe formim bazë dhe të avancuar në shkencat dhe metodologjitë në fushat e laboratorit mjekësor: biokimi, hematologji, mikrobiologji, histopatologji. Volumi që zënë orët e laboratorëve dhe praktikës profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të praktikohen gjatë manipulimeve dhe punës së pavarur. <i>(Aneks II/3.3 RVB-tabela e planit mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit</p>	<p>Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë dhe lëndëve të formimit profesional në mjekësi laboratorike përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, psikologji, deontologji dhe legjislacion. Këto lëndë</p>



dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	kontribuojnë për të shtuar aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese, për formimin jo vetëm si profesionist por dhe qytetar. <i>(RVB-tabela e planit mësimor, syllabuset)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Analiza e rezultateve të provimeve në nivel lënde dhe departamenti i jep stafit akademik një vision të plotë për shkallën e asimilimit të njohurive dhe të përfitimit të kompetencave. <i>(Aneks II/24.2)</i>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në përmbledhjen e lëndës pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Studentët marrin pjesë aktive në diskutim. Studentët mund të përdorin ambientet laboratorike edhe jashtë orëve të programit mësimor. Ata asistohen nga pedagogët për të zgjidhur çështjet e rëndësishme teoriko-praktike. Në fund të praktikës profesionale pedagogu dhe mbikqyrësi i praktikës analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. Veçori e vlerësimit të praktikës është vlerësimi veç aftësive dhe i përgjegjshmërisë, cilësi e domosdoshme për specialistin e ardhshëm. <i>(RVB, takimet në institucion)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon trainime apo leksione jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre. Tashmë është traditë në KU Logos organizimi i konferencave internacionale dhe konferencave studentore. Gjatë periudhës së pandemisë aktivitetet ekstrakurrikulare u kufizuan vetën në ëbinare për përditësimin e informacioneve për Covid19. Aktivitetet kanë rifilluar në vitin e fundit. Në dosjen e programit të studimit institucioni ka paraqitur dhe dokumentacion lidhur me aktivitetet shkencore dhe publikimet. <i>(Aneks V/1-6)</i>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Në programi Bachelor në "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë" janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Një pjesë e tyre janë lider të spikatur në fushat përkatëse. Bazuar në CV e stafit akademik që u vunë në dispozicion, fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. <i>(CV e stafit akademik, takimet në institucion)</i>




<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminareve apo aktiviteteve trainuese të cila ju mundësojnë studentëve aftësitë organizuese dhe drejtuese, komunikimit me etike midis kolegëve. Në ambientet e laboratorëve mjekësorë procesi ekzaminues është punë në grup. Stafi akademik inkurajon edukimin e punës në grup për zgjidhjen e problemeve.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Në zhvillimin e procesit mësimor liria akademike që siguron institucioni, ju mundëson pedagogëve përdorimin e metodave të ndryshme në mësimdhënie, në detyrat e kursit apo në punimin e temave të diplomës. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore nga studentë në bashkëpunim me pedagogët.</p> <p>Në takimet në institucion u informuam se ritmi i kërkimit në këto 2 vite akademike kanë qenë të ulura për shkak të efektit të pandemisë Covid19. Në tabelat 19, 20 të RVB jepen të dhëna statistikore për aktivitetet individuale dhe bashkëpunimet shkencore.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Institucioni mbështet dhe inkurajon zhvillimin e ideve inovative dhe studimet kërkimore shkencore të stafit akademik. Në takimin me stafin akademik u informuam se ka patur dhe mbështetje financiare për pjesmarrje në konferenca internacionale dhe botime. Synohet në të ardhmen një përfshirje më e madhe e studentëve në aktivitete të partneritetit me institucione jashtë vendit për realizimin e projekteve shkencore. Synohet përfshirja e institucionit në projekte të mirëfillta kërkimore shkencore me mbështetje të partnerëve ndërkombëtare. <i>(takimet në institucion, Aneks IX/5.1, 5.2)</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>KU Logos ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh universitare jashtë vendit. Në takime u referua që ka patur një mobilitet të kënaqshëm të pedagogëve përmes marrëveshjeve Erasmus+ si dhe aktivizim të tyre me pjesmarrje në trajnime dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit. Mobiliteti i studentëve ka qenë në shifra të ulura, referuar situatës së pandemisë. Synohet që në të ardhmen të shtohet numri i studentëve që marrin pjesë në programet e këmbimit Erasmus+. Në rregulloren e programit të studimit parashikohen procedurat e transferimit dhe njohjes së ECTS për studentët e këtij programi.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” mbyllet me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe/ose punim diplome. Në rregulloren e KU Logos, ka një kapitull të dedikuar për procedurën e diplomimit ku përcaktohen kushtet që duhet të përmbushë studentit para diplomimit. <i>(Aneks II/2)</i>. Studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe të ketë fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit. Studenti, para hyrjes në provimin e përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me Kolegjin Universitar “Logos”. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara përcakton se të drejtën për të përgatitur diplomë e kanë studentët me notë mesatare që plotëson kriteret e departamentit. <i>(Aneks II/3.1)</i></p> <p>Në rregulloren e programit të studimit, në kreun 6, jepen detaje mbi procedurën e diplomimit. Në muajin e parë të vitit akademik, Departamenti ve në dispozicion të studentëve pyetjet e provimit përfundimtar dhe temat e diplomave. Kriteret për përfshirje në punim diplome vendosen nga departamenti. Procedura përshkruhet e plotë në rregullore. <i>(Aneks II/3.3)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Departamenti organizon konsultime me studentët për tematika të ndryshme të programit të provimit sipas një grafiku të miratuar nga Dekani dhe të shpallur në mjediset publike. Provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit me provim ose me përgatitjen e një teme diplome. Pedagogët i orientojnë studentët dhe ju japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të</p>



	shfrytëzojnë në hartimin e temës së diplomës, skicimin e strukturës së studimit mbledhjen e informacionit apo realizimin e tij në laboratorët e departamentit apo institucionet shëndetësore me të cilat bashkëpunon institucioni si dhe prezantim e materialit. Departamenti harton listën e fushave prioritare dhe miraton listën e temave të diplomave dhe udheheqësit e tyre (<i>Aneks II/2, VII/17</i>)
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga 4 pedagogë efektivë dhe të jashtëm, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit caktohet nga dekani. Teza e provimit hartohet nga komisioni në bazë të bankës së pyetjeve përmban pyetje për çështjet kryesore të trajtuara gjatë gjithë programit të studimit. Provimi organizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar (me shkrim dhe me gojë). Me mbarimin e provimit komisioni shpall përgjigjet e provimit/tezave në mjediset publike. Korrigjimi i tezës bëhet nga komisioni, i cili shënon pikët e fituara në faqen e sekretimit. Heqja e sekretimit bëhet nga komisioni në prani të Dekanit. Rezultatet paraprake shpallen në mjediset publike të fakultetit.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. Pedagogët i orientojnë studentët dhe ju japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të shfrytëzojnë.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Realizimi i temës së diplomës bazohet në rregulloret e institucionit. Në rregulloren e KU Logos theksohet se punimi i diplomës përmban çështje, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit që, nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave projektuese, probleme të prodhimit, praktikës laboratorike apo për të punuar me literaturën në fushën përkatëse. Punimi i diplomës përcaktohet në mënyrë të tillë që të përfshijë domosdoshmërisht eksperimentin ose kërkim apo vjelje të dhënash në terren. Institucioni i siguron studentëve infrastruktrën e nevojshme logjistike për realizimi e studimit. Studentët mbledhin të dhënat në strukturat shëndetësore ku realizohet studimi ose realizojnë pjesën eksperimentale në laboratorët e departamentit.

<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës asiston dhe orienton studentit në realizimin e temës së diplomës: në hartimin e strukturës së temës, metodologjinë e hartimit, shkrimit apo prezantim e studimit, në përzgjedhjen e literaturës për pjesë teorike, mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre, përpunimin statistikor, etj. Udhëheqësi i temës garanton vërtetësinë dhe cilësinë e rezultatit dhe jep miratimin me shkrim për paraqitjen e temës në komisionin e vlerësimit. Para prezantimit në komisionin e vlerësimit, tema vlerësohet dhe nga 2 reçensentë. <i>(Aneks VII/17)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i provimit të diplomës apo temës bëhet me notë. Teza e provimit të diplomës ka 100 pikë maksimale. Teza korrigjohet nga komisioni i vlerësimit. Proçes verbali përfundimtarë firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në sekretari. Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisionit të ngritur nga Departamenti, e cila e vlerëson studentin me notë, bazuar në punën e tij dhe vlerësimin e udhëheqësit të temës. Tema e diplomës vlerësohet me pikë individuale nga secili anëtar i komisionit dhe në fund llogaritet mesatarja aritmetike. <i>(Aneks II/2, 3.3)</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën (me punim diplome ose provim përfundimtar/të përgjithshëm), pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Në vizitën në sekretarinë e institucionit, GVJ u njoh me formatin e Diplomës dhe suplementin për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laborator Mjekësorë” studentit merr suplementin e diplomës që përmban informacion të detajuar për programin e studimit <i>(Aneks II/2)</i>.</p> <p>Me kërkesë të tij, në çdo kohë studentit i vihet në dispozicion kopja e plotë zyrtare e programit të studimit. Proçedura është rregulluar me urdhër Rektori.</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretaritë mësimore të fakultetit gjëndet regjistri themeltarë i studentëve, regjistri i vlerësimeve të marra nga studentët gjatë viteve të studimit në programin e studimit dhe regjistri i tërheqjes së diplomës. Sekretaria mësimore, përgjegjëse për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave punon mbështetur në rregullore të funksionimit dhe arkivimit.</p>

	GVJ vizitoi ambientet e sekretarisë ku u njoh me mënyrën e menaxhimit të informacionit për studentët (u konsultuan dosje studentësh dhe regjistrat themeltarë) dhe për pedagogët (u konsultuan dosjet dhe kontratat). GVJ u njoh dhe me ecurinë e procesit të dixhitalizimit të informacionit dhe arshivës së sekretarisë (<i>AneksII/17, 18</i>)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit, si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. Ky proces menaxhohet nga zyra e burimeve njerezore (<i>Aneks. II/5; IV/4</i>). GVJ u informua gjatë vizitës në Institucion, (takimi me përfaqësuesit e zyrës së burimeve njerezore) mbi procedurën që ndjek kjo zyrë për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të stafit. Institucioni është duke punuar për digitalizimin e dokumentacionit. Çdo fillim viti stafi çon CV-të e përditësuara, si dhe gjithë dokumentat e tjera të karakterit administrativ. Ekziston një komunikim interaktiv midis stafit dhe burimeve njerezore. Dosja e personelit ka elementë akademikë dhe administrativë. Dokumentacioni akademik përfshin diplomën, CV të përditësuara dhe noterizuara, raportime për pjesëmarrje në konferenca, letrat e references etj.

	Elementët administrative të dosjes janë: librezë shëndetësore, dëshmi penaliteti, librezë e punës, ID.			
Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni përcakton kritere, si dhe procedura të qarta për rekrutimin e stafit akademik (RVB, fq 45, Aneks. II/5; IV/4), si dhe synon rekrutimin e një stafi të kualifikuar. Rekrutimi bëhet mbi bazën e nevojave të evidentuara nga njësia bazë duke respektuar kuotat e miratuara nga bordi i administrimit.			
Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Logos harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, duke evidentuar në çdo fillim viti nevojat për personel me kohë të plotë dhe ty pjesëshme. Kërkesat shqyrtohen në përputhje me numrin e miratuar nga Bordi i Administrimit. GVJ u informua nga përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore se rekrutimi nis me kërkesat nga departamenti të cilat i përcillen dekanit, më tej Rektorit dhe Administratori bën shpalljen në web. Lihet koha e nevojshme për aplikimet e kërkesave. Komisioni <i>ad hoc</i> mblidhet për të bërë intervistimet me pjesëmarrësit, si dhe vlerësimin sipas sistemit të pikëzimit dhe më tej fituesi shpallet nga rektori. Njoftimi përkatës bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore (Aneks. II/5, IV.4). Institucioni deklaron se ka qëndrueshmëri me personelin e ftuar.			
Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedura korekte të punësimit, duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, kodin e punës si dhe me rregulloren e përgjithshme (Aneks. II/2; IV/2). Institucioni në rekrutimin e personelit ndjek politikën për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivel të lartë kualifikimi, duke preferuar fillimisht personelin e me grade shkencore të fituar jashtë vendit (Aneks. IV/12). Gjithashtu institucioni ndjek politikën e rinovimit në moshë të stafit (Takimi me Zyrën e Buqimeve Njerëzore). Këto politika ndiqen kryesisht nën kujdesin e departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se, KU Logos siguron një mjedis të përshtatshëm për të gjithë personelin akademik, për kryerjen sa më të mirë të aktiviteteve akademike dhe shkencore. Logos disponon laboratorë mësimorë si dhe salla leksioni dhe seminaresh të paisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor (Aneks. IX/7). KU Logos çdo fillim viti akademik sipas propozimeve të njësive bazë dhe kryesore, miraton në Senatin Akademik planin vjetor të veprimtarisë akademike dhe kërkimore që kanë të bëjnë me zhvillimin, integrimin dhe pjesëmarrjen e personelit të Kolegjit. (Aneks. V/4) (Vizita në ambientet e Institucionit/Departamentit).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Stafi akademik mbështetet nga Institucioni për trainimin e tij të vazhduar. Institucioni ndjek një plan trainimi sipas prioriteteve. (Aneks. 4.2. Plani strategjik i Departamentit të Shkencave Mjekesore)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit, përmes rrugëve të ndryshme. Personeli është i kualifikuar dhe ka përdorur metodat e reja të mësimdhënies, si dhe teknologjisë së informacionit, gjatë periudhës së pandemië. Stafi është mbështetur me udhëzues përkatës si dhe me trainime të ndryshme për përdorimin e metodave <i>e-learning</i> në mësimdhënie (Aneks. I/7; I/81 II/15; XI/4; 5.1; 5.2). Mbështetje në këtë aspekt janë dhe kualifikimet në kuadër të programeve Erasmus (Aneks. VI/7.2).</p> <p>Janë bërë trainime për mënyrën e mësimdhënies. psh. Me Bashkinë e Tiranës si pjesë e “Tirana smart” projekt që konsistonte në shkëmbim experience për mënyrat e mësimdhënies. Po kështu janë kryer dhe trainime në fokus sfidat e pandemisë. Janë realizuar shkëmbime të mira eksperiencash dhe pse online</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Stafi mbështetet nga institucioni si për realizimin e ngarkesës mësimore (Aneks. IV/2), ashtu dhe për realizimin e aktiviteteve kërkimore, apo edhe për angazhimet në shërbim të institucionit. Stafi akademik vlerësohet në mënyrë periodike përmes rrugëve të ndryshme, nga drejtuesit, përmes vetëvlerësimit, por edhe nga studentët përmes pyetësorëve (Aneks. VI/3 dhe IV/7).</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Mjekësore e zhvillon aktivitetin akademik në funksion të programit të studimit “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë“ në kampusin Nr. 1 dhe siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike duke plotësuar kushte higjieno sanitare (<i>Ev X/2, 3, 4, 5</i>), standartet akustike (<i>Aneks. X/2, 5, 8.1</i>). Në dispozicion për realizimin e këtij program studimi janë 4 salla leksioni, 3 klasa seminaresh, të paisura të gjitha me mjetet e nevojshme dixhitale si (PC, projector, wifi etj.) 3 laboratorë të paisur me të gjitha materialet dhe infrastrukturën e nevojshme, salla biblioteke. (<i>Aneks. X/5.1; vizita në ambiente e institucionit</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Mjekësore, LOGOS ka mjedise bashkëkohore për zhvillimin e aktivitetit akademik, salla leksionesh, seminaresh, laboratorë, bibliotekë etj të paisura me të gjithë infrastrukturën bashkëkohore, me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Në periudhën e fatkeqësive si tërmeti i vitit 2019, apo dhe të pandemisë Institucioni adaptoi platformën e menaxhimit të të nxënitorit eduPage, si dhe me platforma të tjera si MS TEAMS. (<i>Aneks. XI/4; 5</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelieret apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave</p>	<p>Departamenti ka pjesë të infrastrukturës dhe shfrytëzon për realizimin e këtij program studim Laboratorin Biokimik Hematologjik, Laboratorin Mikrobiologjik dhe Laboratorin Histopatologjik të cilët kryejnë një larmi të madhe analizash duke u ofruar dhe mjaft shprehi praktike studentëve. (<i>Aneks. IX/7</i>)</p>



formues të programit të studimit në tërësi.									
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Në sfunksion të programit të studimit janë dhe laboratorët e informatikës të pajisur me kompjutera dhe programe specifike në funksion të programit të studimit. Biblioteka ka ambjentet e pajisura me kompjutera dhe me platforma online që mund të përdoren nga të interesuarit. <i>(Aneks. X/5.2; Vizita në ambjentet e institucionit)</i>								
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Ambjentet janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Klasat janë të përshtatshme jo vetëm për grupe mësimore me numër të vogël studentësh, por edhe me një numër të madh. Departamenti shfrytëzon laboratorë informatike, si dhe salla interneti sipas standarteve. Si rjedhojë e marrëveshjeve të Logos me institucione shëndetësore publike dhe private, studentët njihen me zhvillimet e reja të laboratorit, si dhe të realizimit të kërkimit shkencor të përbashkët. <i>(Aneks. VIII/1)</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Logos disponon dy biblioteka që ndodhen në kampusin qendror në Tiranë, si dhe në Kampusin e Shën Vlashit në Durrës, ku studentët përdorin literaturën fizike dhe elektronike, si në ambjentet e bibliotekës, ashtu edhe jashtë saj. <i>(Aneks. II/21, Vizita në Bibliotekën e kampusit qendror)</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e	Gjatë vizitës, grupi i vlerësimit të jashtëm u informua dhe vizitoi bibliotekën në kampusin qendror në Tiranë, e cila ishte e paisur me infrastrukturën e nevojshme (vënde për studim, internet, kompjutera etj), por edhe burimet e nevojshme të literaturës në mbështetje të studentëve dhe stafit akademik. Institucioni u siguron akses studentëve dhe stafit në dy biblioteka te rëndësishme si EBSCO, J-Stor dhe Pubmed.

Stefano


<p>përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është pasuruar me shumë tekste mësimore bazë dhe ndihmëse, në gjuhë të huaj dhe shqipe, me tekste elektronike, revista shkencore etj. GVJ konkludon se institucioni i ka përmbushur rekomandimet e lëna nga GVJ në akreditimin e mëparshëm (<i>Aneks. XI/7/7</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka jo ka një fond të gjerë, si libra shkencorë, revista, buletine etj. Institucioni u ka ofruar studentëve dhe stafit akademik përdorimin e Bibliotekës Digjitale EBSCO, JSTOR, PubMed, të cilat ofrojnë burime bashkekohore. Burimet online kane lehtësuar shume sigurimin dhe përdorimin e literatureës nga studentët, veçanërisht gjatë peiudhës së pandemicë. (<i>Aneks. XI/7.5</i>). Studentët trainohen për përdorimin e bibliotekës, vecanërisht asaj elektronike.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është plotësisht e shfrytëzueshme nga studentët dhe stafi, pasi ajo është e paisur me kompjutera, ku janë të instaluar programet e Office, si dhe mundësitë e përdorimit të internetit. Biblioteka ka katalogun elektronik PLEJADES i cili lehtëson përdoruesit e bibliotekës për tu orientuar dhe gjetur burimet e nevojshme të literaturës.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton një plan të detajuar strategjik për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit, me materiale në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, pasurim i cili bëhet permes rrugëve të ndryshme (<i>Aneks. II/20</i>). Pasurimi i bibliotekës bëhet duke u bazuar në kërkesat e paraqitura nga departmenti për tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj dhe aktualisht gjenden 154 tituj, 137 prej të cilëve janë të rinj. GVJ konkludon se Institucioni i ka përmbushur rekomandimet e lëna nga GVJ gjatë akreditimit të mëparshëm (<i>Aneks. XI/7.7</i>).</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka frekuentohet gjatë gjithë javës dhe në orare të zgjatura e të përshtatshme për tu shfrytëzuar nga studentët apo stafi. Studentët orientohen për literaturën nga pedagogët e modulit, por edhe përmes syllabusit. Trainimet e studentëve, link-et, oraret bëhen publike permes faqes zyrtare të KU LOGOS.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	LOGOS përdor sistemin e menaxhimit të informacionit në përputhje me rregulloren e tij (<i>Aneks. II/13</i>) i gjithë dokumentacioni për studentët në formë të printuar dhe elektronike gjendet në sekretarinë mësimore dhe ruhet në përputhje me rregulloren e kësaj sekretarie (<i>Aneks. II.8</i>). Përmes rrugëve të ndryshme dhe sistemeve të shumta në përdorim, sekretaria gjeneron dhe ruan një numër të madh statistikash vjetore. Në të gjitha ambientet e institucionit ka internet në dispozicion të stafit dhe studentëve. LOGOS përdor sistemet online Edupage dhe TEAMS, të cilat përdoren për ruajtjen e informacionit për stafin, duke përfshirë këtu informacione personale, leksione etj.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	LOGOS përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore menaxhon dhe administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e gjithë personelit të kategorive të ndryshme, në përputhje me rregulloren për arkivin e Institucionit (<i>Aneks. II/7</i>). Zyra e Administrimit të Fakulteteve përgatit raporte vjetore të cilat i dorëzon në MASR, ndërsa sektori IT siguron digitalizimin dhe ruajtjen e të dhënave.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sigurimi i aksesit të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit realizohet përmes sistemit Edupage (<i>Aneks. XI/4</i>). Të dhënat e nevojshme për çdo student përpunohen nga sekretaria mësimore në përputhje me sistemin qendror kombëtar (<i>Aneks. II/18</i>).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Komunikimi interaktiv dhe shkëmbimit i informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, realizohet përmes platformës Microsoft 365, MS Teams, Edupage (<i>Aneks. XI/4; 5</i>). Të dhënat personale, si dhe kontaktet e studentëve ruhen nga sekretaria mësimore.



<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit akademik dhe i studentëve realizohet përmes sistemeve Edupage dhe Microsoft 365. Raportimet individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët lehtësohen përmes përdorimit të këtyre sistemeve (<i>Aneks. XI/4; 5</i>)</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga LOGOS, struktura administrative, njoftimet e ndryshme bëhen publike në faqen zyrtare të LOGOS, në gjuhën shqipe dhe angleze (<i>Aneks. XI/1</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>LOGOS harton një raport financiar, si pjesë e Raportit Vjetor, i cili përgatitet në nivelin e Institucionit, i ndarë sipas fakulteteve dhe jo në nivelin e programit të studimit, pasi siç pohoet në (<i>RVB faqe 52</i>), institucioni është me përmasa modeste. GVB afirmon se në të ardhmen me ritjen dhe zhvillimin e institucionet, ky raport financiar do të përgatitet në nivel departamenti dhe programi studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore shërbim të realizimit të programit shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekën on-line, detyrimet financiare,</p>	<p>Burimet e financimit të programit të studimit janë: (i) buxheji i fondacionit LOGOS; (ii) të ardhurat nga paagesat e studentëve. Për çdo program studimi përgatitet plani financiar për mbështetjen dhe mbarëvajtjen e programeve (<i>Aneks. IX/2; 4; 8; 8.1</i>). Kërkesat e njëjësive bazë reflektohen në buxhet në përputhje me nevojat e institucionit, si dhe planin strategjik. (<i>Aneks. IX/2.1</i>)</p>

<p>grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Auditimi i përvitshëm i jashtëm i institucionit realizohet nga Eksperti Kontabël i Autorizuar i cili përcaktohet me vendim të Bordit drejtues të Fondacionit. Në raportin e përgatitur nga Audituesi i jashtëm, përfshihet një pasqyrë e hollësishme financiare, si dhe e politikave kontabël dhe e sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu jepet opinion mbi realizimin e objektivave financiare. Institucioni përmes Zyrës së Financës dhe Administratorit përgatit raporte 6 mujore mbi ecurinë financiare. <i>(Aneks. IX/3)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni në mënyrë periodike auditon dhe vlerëson efektivitetin e financimit <i>(Aneks. IX/3)</i>, merr në konsideratë nevojat e departamenteve dhe Fakulteteve dhe harton e miraton projekt buxhetin <i>(Aneks. IX/2 8)</i>. Institucioni bën një analizë të situatës, si dhe shpenzimeve financiare dhe bën një axhustim të buxhetit afatmesëm (3 vjeçar).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare, pasi është pjesë e fondacionit LOGOS i cili mbështet veprimtarinë kërkimore dhe shkencore të institucionit. LOGOS ndjek një politikë mbështetje dhe përkujdesje për studentët e cila reflektohet në radhë të parë nga tarifat e ulta, si dhe bursat e studimit. Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme, si dhe kapacitetet njerëzore që mundësojnë hapjen e programeve të reja, rritjen e numrit të studentëve etj. GVJ u informua (Takimi me Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit) se ka një rënie të lehtë të numrit të studentëve, por institucioni mundohet të ruajë një qëndrueshmëri 25-27 studentë.</p> <p>Tarifa e studimit është e ulët. Studentët që mbarojnë studimet kanë mundësi të punësohen menjëherë dhe niveli i punësimit rezulton në masën 70%. Kalueshmëria në provim shteti për marrjen e licensës është 80%, nota mesatare mbi 7. GVJ u informua për bashkëpunimin që LOOS ka me laboratorin e</p>


	Cambridge, ku studentët mund të realizojnë praktikat dhe aktualisht në këtë laborator priten të punësohen dy studentë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me Statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të veta rregullatore (<i>Aneks. II/3.3</i>), por duke rrespektuar dhe autonominë e Institucionit. Kështu pranimi i studentëve bëhet në përputhje me kuotat e miratuara, si dhe me kriteret e pranimit të specifikuar në statutin e KU LOGOS (<i>Aneks. II/1</i>), nën kujdesin e Zyrës së çështjeve studentore. Kriteret bëhen publike përmes rrugëve të ndryshme, duke përmendur këtu edhe fushatat promovuese (<i>Aneks. III/5.3</i>). Informacionin për programin e studimit “Teknikë i Lartë në Laboratorë Mjekësorë”, studentët e kanë marrë përmes burimeve të ndryshme, psh përmes shokëve, të afërmeve që kanë studjuar më parë. Studentët shprehen të kënaqur për informacionet e marra nga sekretaria mbi programin e studimit, bursat etj. Informacioni nga web site, në këndvështrimin e studentëve gjithashtu është i kënaqshëm dhe i plotë. Studentët shprehen të kënaqur dhe për aspektin financiar. Studentë që kanë mbaruar shkollat e mesme që janë pjesë e fondacionit janë orientuar dhe ndihen të kënaqur. (<i>Takimet me studentët</i>)</p> <p>GVJ u informua gjatë takimit me zyrën e këshillimit të studentëve mbi aktivitete të ndryshme informues. E tillë është</p>

	<p>dhe “Open day”, aktivitet ku ftohen gjimnazistët e interesuar brenda fushes së mjekësisë. Institucioni organizon workshope dhe maturantët vizitojnë dhe laboratorët. Institucioni përdor mediat sociale, <i>you tube</i>, instagrame fcb etj, si mjete për përhapjen e informacionit. Zyra e studentëve merret me regjistrimin, orientimin, këshillimin ambjentet, plan programin, regjistrimet etj. Në fillim të vitit akademik studentët shpërndahen nëpër auditorë ku prezantohen me stafin dhe paisen me një dosje ku kanë gjithë dokumentacionin e nevojshëm, rregulloret, informacione të rëndësishme psh si mund të bëhen pjesë e këshillit studentor etj. Pas përfundimit të studimeve, ata, bëhen pjesë e rjetit alumni. Kontaktet me rjetin alumni mbahen fillimisht permes plotësimit të një formulari. Më tej në vitet në vazhdim zyra i ruan kontaktet permes formularëve të dërguara online. Institucioni ndjek politika dhe procedura që garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit, të cilat janë të sanksionuara në rregulloren e Institucionit (<i>Aneks. II/2</i>). Informacioni i nevojshëm për studentët bëhet publik permes faqes zyrtare të institucionit, si dhe portalit U-Albania.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit, e përzgjedhjes së studentëve për programin e studimit, hartohen duke u bazuar dhe në propozimet e departamenteve (<i>Aneks. I/6</i>). Kriteret, kuotat, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen në rregulloren e Institucionit (<i>Aneks. II/3; 1; 2</i>). Mënyrat e informimit janë të shumta, si permes faqes zyrtare të institucionit, fletëpalosje, broshura, ditëve të informimit dhe këshillimit të maturantëve etj. (<i>Aneks. VII/3.1; 3.5; 5; 6</i>). GVJ u informua gjatë takimit me studentët se kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme. (<i>Takimi me studentët</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të</p>	<p>LOGOS harton dhe publikon në faqen zyrtare, si dhe në portalin e maturantëve, përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve, bazuar në propozimet e Departamentit të Shkencave Mjekësore të miratuara nga Senati Akademik. Zyra studimeve e informoi GVJ se ata ndjekim udhëzimet e MASR për të gjitha kategoritë e studentëve. Institucioni ka një procedurë të qartë dhe të</p>




<p>kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>ndjekur korrektësisht në përputhje me rregulloren e transferimeve të studimeve drejt LOGOS, me të cilat GVJ u njoh permes zyrës së studimeve dhe studentëve. Ardhjet drejt këtij programi studimi janë të spikatura Sidomos ata që kanë mbaruar një program studimi, sidomos Biologji, ku u njihen disa lëndë të zhvilluara. Largimet nga ky program drejt të tjerave thuhetse mungojnë. GVJ u informua nga përfaqësuesit e zyrës së studimeve se ata mbajnë statistika mbi punësimin dhe referuar këtyre statistikave, mbi 75% e studentëve janë punësuar brenda profesionit. Programi u jep mundësi studentëve të liçensohen dhe të dalin në treg. Nëse kanë interes ata dhe mund të rikthehen në për të vijuar studimet Master Profesional për tu kualifikuar më tej. LOGOS ofron master professional të cilin e ndjekin mbi 50% e studentëve që mbarojnë Bsc. Nëse studentët punësohen pas mbarimit të Bsc, ata rikthehen dhe e vijojnë përsëri në LOGOS masterin profesional.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit, kuotat për çdo program studimi janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, duke ndjekur një politikë mbështetëse për kategori të caktuara studentësh. Ky informacion, si dhe kriteret bëhen publike në faqen web të institucionit</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>LOGOS përpara fillimit të çdo viti akademik informon publikun dhe udhëzon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit duke e realizuar këtë proces me forma dhe mundësi të ndryshme, madje dhe në periudha të veçanta, siç ishte periudha e pandemisë Covid 19. Mënyrat e komunikimit janë të larmishme si permes takimeve informuese me shkollat e mesme në vend, permes komunikimeve online, permes panairëve, mediave, rjeteve sociale etj (<i>Aneks. VII/3.1; 3.2, I/6</i>)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------



<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni bën publike përmes fletëve informuese (<i>Aneks. VII.5</i>) dhe faqes zyrtare, informacionin për programet e studimit në të gjithë elementët e tij, duke përfshirë dhe rregulloret e ndryshme (<i>Aneks. II/3.3</i>), syllabuset, kalendarin akademik mbi provimet dhe riprovimet (<i>Aneks. I/12</i>), kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore (<i>Aneks. II/3.3</i>).</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>LOGOS informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve, transferimeve të kualifikimeve të mëparshme, ose studimeve të pjesshme, duke i bërë publike në faqen zyrtare të vetë institucionit. Në rregulloret e transferimeve (<i>Aneks. II/12; VII/16</i>) përshkruhen qartë procesi i transferimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore (<i>Aneks. II/1</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët e marrin informacionin mbi kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre përmes syllabuseve të përgatitura nga lektori i lëndës (<i>Aneks. III/2.3</i>) në përputhje me parimet e sanksionuara në rregulloren e programit të studimit. (<i>Aneks. II/3.3</i>)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen dhe për modalitetet e mbrojtjes së diplomës dhe procedurës së diplomimit, ashtu siç parashikohet në rregulloren e programit të studimit. (<i>Aneks. II/3/3</i>)</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Institucioni organizon "Ditë të hapura" për informimin e maturantëve për programet e ndryshme të studimit. (<i>Ev VII/3.2; takimi me përfaqësues të sektorit NJSBC, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit</i>)</p> <p>Institucioni shfrytëzon gjithashtu edhe panairët e ndryshme si panairi "Work and Study" në funksion të informimit (<i>Aneks. VII/3.1</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Albena Gjergjani


<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>LOGOS garanton të drejtën e informimit të studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve (<i>Aneks. VII/3.3</i>), duke organizuar aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me zyrën për çështjet studentore, siç parashikohet në rregulloren e fakultetit (<i>Aneks. II/3.1</i>) dhe të programit të studimit (<i>Aneks. II/3/3</i>). Institucioni siguron dhe komunikimin e brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarive mësimore përmes koordinatorit të marrëdhënieve me studentët i cili përcjell të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët. (<i>Aneks. II/9</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>LOGOS vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion të larmishëm si broshura informative, guida studentore, informacione të printurara, informacione në website dhe në platformën MS TEAMS, duke përfshirë këtu edhe rregulloren e fakultetit dhe të programit të studimit. (<i>Aneks. II/3; III/2.3</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>LOGOS përmes Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet dhe orienton ata në tregun e punës, i mbështet përmes trainimeve periodike për plotësimin e dokumentacionit, si dhe për mënyrën e aplikimit për punë. (<i>Aneks. II/22; VI/2.4; 3.2; 3.5</i>). Në mbështetje të këtij procesi janë bashkëpunimet me laboratorë të institucioneve shëndetësore ku studentët kryejnë praktikën, si dhe takimet me alumni të cilët transmetojnë eksperiencat e tyre. (<i>Aneks. II/22; VII/9</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i detajuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet në funksion të realizimit të tij përmes takimeve fizike me ta. Gjatë periudhës së pandemisë kjo u realizua përmes platformave <i>online</i>, si dhe kontaktet me email. Studentët shprehën se u ambjentuan me lehtësi në përdorimin e platformave si Microsoft 365 apo EduPage, falë mbështetjes dhe instruksioneve të pedagogëve gjatë zhvillimit të mësimin në periudhën e pandemisë Covid 19. (<i>Takimi me studentët</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>Studentët informohen mbi programin e studimit përmes sistemeve digjitale si EduPage dhe MS Teams, në mënyrë të individualizuar (<i>Aneks. XI/4; 5</i>). Ky informacion arrihet me lehtësi, edhe në distance, ku studentët mund të marrin informacion mbi zhvillimin e procesit mësimor, lëksionet e</p>

lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	regjistruara, komunikim me pedagogët etj. <i>(Takimi me studentët)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>LOGOS përmes sekretarive mësimore <i>(Aneks. VII/13)</i> disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit që përdoren për kryerjen e analizave dhe raporteve vjetore të cilat dorëzohen pranë MASR. <i>(Aneks. II/24; 24.1; 24.2)</i></p> <p>Referuar <i>(tabelës 23 Aneks 05. Tabelat përmbledhëse të RVB)</i>, numri i të diplomuarve për programin e studimit dhe punësimi me përputhje me diplomën është:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr i të diplomuarve</th> <th>Nr i të punësuarve në përputhje me diplomën</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>35</td> <td>27</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>7</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>26</td> <td>18</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Nr i të diplomuarve	Nr i të punësuarve në përputhje me diplomën	2018-2019	35	27	2019-2020	7	5	2020-2021	26	18
Viti akademik	Nr i të diplomuarve	Nr i të punësuarve në përputhje me diplomën											
2018-2019	35	27											
2019-2020	7	5											
2020-2021	26	18											
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore e LOGOS është përgjegjëse për të siguruar statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>U verifikua regjistri themeltar i studentëve për këtë program studimi si dhe regjistri i arritjeve akademike nga ku rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> - V.A. 2019-2020 27 studentë të regjistruar; - V.A. 2020-2021 30 studentë të regjistruar; - V.A. 2021-2022 40 studentë të regjistruar; 												




Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore e LOGOS disponon dhe ruan në përputhje me legjislacionin, të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre (<i>Aneks. VII/13</i>), duke përdorur edhe sistemin EduPage. (<i>Aneks. XI/4</i>)			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore e LOGOS menaxhon të dhënat statistikore të studentëve përmes sistemit të brendshëm të informacionit, të cilat për të qenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar ruhen në formë të printuar dhe elektronike.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	LOGOS harton raporte analitike vjetore mbi veprimtarinë e tyre të cilat i dorëzohen MASR, duke përdorur të dhënat e sekretarisë mësimore, Zyra e çështjeve studentore dhe këshillimit të Karrierës, si dhe të departamentit. (<i>Aneks. II/24.2</i>). Këto raporte përmbajnë informacion dhe të dhëna mbi numrin e studentëve, transferimet e studentëve, cilësinë në hyrje dhe dalje, si dhe të dhëna mbi punësimin e tyre. Raporti gjithashtu pasqyron masat dhe politikat e strategjitë e duhura që duhet të ndiqen në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale si senati akademik, komisioni i përhershëm i mardhënieve me studentët, këshilli i etikës, grupet e vlerësimit (<i>Aneks. I/1; 9; 10; 4.15</i>), si dhe në vendimmarrjet dhe diskutimet në mbledhjet e Deartamentit, në përputhje me dokumentat rregullatore (<i>Aneks. II/23; 23.1</i>); këshillat studentore (<i>Aneks. 1.17</i>). Koordinatori i mardhënieve me studentët shërben si urë lidhëse për përcjelljen e llojeve të ndryshme




	të informacionit, duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi. <i>(Aneks. II/9)</i>			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Logos inkurajon përfshirjen e studentëve apo të përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje përmes pjesëmarrjes së tyre në Senatën Akademik, Komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë në arsimin e lartë, këshillin e etikës, si dhe GVB. <i>(Aneks. I/11; 9; 10; 14; 15)</i> Gjithashtu NJSBC organizon dhe administron plotësimin e pyetësorëve të studentëve për lëndë të ndryshme. <i>(Aneks. VI/3; 5; 6)</i>			
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Për programin e studimit “Teknike e Lartë në Laboratorët Mjekësorë” është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi, duke respektuar bazën ligjore <i>(RVB, fq 60)</i> . Institucioni gjithashtu, ka parashikuar dhe zbaton procedurë për transferimin e studimeve të studentëve, pa pengesë, në përputhje me aktet e veta rregullatore, madje duke i ndihmuar studentët në plotësimin e dokumentacionit.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	LOGOS garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit, duke e sanksionuar këtë në rregulloren e vetë institucionit dhe ky kontribut i studentëve është i dokumentuar <i>(Aneks. I/2, Takimi me studentët)</i> . Vlerësimet periodike të studentëve në procesin e mësimdhënies konsiderohen nga NJSBC dhe përfshihen në raportet vjetore të përgatitura nga kjo njësi. <i>(Aneks. VI/5; 6)</i>			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u garantohej përmes rregullores së Fakultetit, barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve. Procesi i vlerësimit kryhet brenda afateve të përcaktuara dhe procedurave të hapura e të qarta. Rregullorja parashikon mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e personave përgjegjës. Vlerësimet e studentëve për procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve në të gjithë elementët e tij përfshihen gjithashtu në raportet e NJSBC. <i>(Aneks. VI/3; 6)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	IAL informon studentët me rrugë dhe mënyra të ndryshme, përmes zyrave të ndryshme si sekretaria mësimore, Zyra e çështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës, vetë Departamenti, si dhe koordinatori i marrëdhënieve me studentët, sipas akteve rregullatore (<i>Aneks. II/2</i>). Këto struktura, si dhe Koordinator i studentëve janë në mbështetje të vazhduar të studentëve, duke i orientuar dhe këshilluar studentët përgjatë ciklit të studimit, sipas planeve individuale të hartuara paraprakisht.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Logos garanton informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, përmes strukturave të ndryshme duke filluar nga vetë Departamenti, Zyra e çështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës, koordinatori për marrëdhëniet me studentët. Mundësi të tjera informimi janë përmes faqes zyrtare, apo platformave dixhitale duke lehtësuar procedurat dhe për studentët në distance.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	LOGOS orienton dhe informon studentët e të gjitha niveleve përmes zyrave të posaçme përmes trainimeve, forumeve, seminareve, tryezave rrumbullake, materialeve që shpërndahen në rrugë të ndryshme etj, (<i>Aneks. II/22; IV/5.3; VII/3.2</i>) drejt tregut të punës dhe ndihmon në integrimin e tyre në tregun e punës. Informacionet që u jepen studentëve janë të larmishme, për çështje të shumta si mbi bursat, konferencat, mobilitete etj. (<i>Aneks. VII/4.1; 4.2; 4.3; V/7.2</i>). Studentët orientohen për praktikën profesionale në institucione të tjera publike apo private, si rjedhojë e marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit. (<i>Aneks. VII/9.2; 11.5</i>)
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e	Zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e



e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	punësimit të studentëve, të cilat i përpunon dhe përgatit një raport që i vihet në dispozicion departamentit dhe Institucionit për t'i shfrytëzuar në të ardhmen për të përmirësuar punën në të ardhmen. <i>(Aneks. VII/9; 9.1)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	LOGOS ka struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC) në përputhje me bazën ligjore në fuqi <i>(Aneks. II)</i> . Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë të cilët operojnë në përputhje me rregulloret, politikat e Institucionit për sigurimin e cilësisë, si dhe duke përdorur instrumenta të miratuara. <i>(Aneks. II/11, VI/1 dhe 3)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në të cilin përfshihen dhe përfaqësues të stafit akademik janë struktura që punojnë dhe operojnë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilët operojnë në përputhje me Rregulloret. <i>(Aneks. Aneks VI/2;3; 4 dhe takimi me NJSBC)</i>

Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

LOGOS përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë sic janë vlerësimet e performances së stafit akademik, pyetësorët për studentët për vlerësimin dhe matjen e cilësisë së mësimdhënies (*Aneks. VI/3*). Përpunimi i informacionit të mbledhur, i cili realizohet nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të cilësisë u bëhet me dije Departamenteve shoqëruar me rekomandimet përkatëse. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në LOGOS realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit përmes ASCAL. (*Aneks VJ/5; 6 dhe Takimi me NJSBC*)

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Disa nga instrumentat matës që përdor institucioni për sigurimin e cilësisë janë vlerësimet e performances së stafit akademik, pyetësorët e studentëve për cilësinë e mësimdhënies për pedagogët, lëndën, si dhe pyetësorët për vlerësimin e Departamentit (*Aneks. VI/3*). GVJ u informua nga përfaqësues të NJSBC se institucioni përgatit formularë të caktuar ku përgjegjësi i Departamentit vlerëson anëtarët e Departamentit, Dekani vlerëson Përgjegjësat e Departamenteve. Gjithashtu, është krijuar dhe një formular i vetëvlerësimit të stafit dmth çdo antar vlerëson veten. Informacioni përpunohet nga NJSBC dhe i përcillet Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ky vlerësim bëhet edhe për stafin administrativ. Departamenti i Shkencave Mjekësore përgatit raportet periodike vjetore ku evidentohen problematika të ndryshme, pikat e dobta, të forta, si dhe hapat për përmirësimin e cilësisë. (*Aneks. II/4.2*)

Shkalla e përmbushjes së standardit

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.

Njësia për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë është ngritur në nivel Departamenti. Gjithashtu LOGOS ka ngritur grup pune për rishikimin e kurikulave, si rjedhojë e nevojës së lindur dhe përmirësimi i kurikulës është bërë në masën 20%, në përputhje me bazën ligjore (*Aneksi I/2*). GVJ u informua nga


Albert Gjonmali

	<p>anëtarët e NJSBC se institucioni nuk ka zyrë të kurikulës, por mbulohet nga NJSBC. LOGOS përdor mekanizma të caktuar për shqyrtimin, miratimin e vazhduar të programeve të studimit. Departamenti bën propozime për ndryshime dhe përmirësime të kurikulës, si dhe ia përcjell NJSBC dhe me tej Komisionit për Garantimin e Cilësisë. NJSBC dhe Komisioni shikon më tepër pjesën e rregullores dhe ligjshmërisë. Komentet e këtyre njësive i përcillen përsëri Departamentit.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni përgatit raporte vjetore bazuar në informacionet e marra përmes analizave në nivel departamenti (<i>Aneks. II/24; 24.2</i>). Proçeset e realizuara për sa i përket mbikëqyrjes së programit Bsc në Teknikë e lartë në laboratorët mjekësorë, evidentoohen përmes procesverbaleve.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>LOGOS përdor instrumenta të ndryshëm mates për ecurinë e programeve të studimit (<i>Ev VI/7</i>). Mbikqyerja e programeve të studimit bëhet nga NJSBC përmes pyetësorëve të studentëve. Përfaqësuesit e NJSBC e informuan GVJ se çdo fillim viti i kërkohet stafit nga ana e përgjegjës të Departamentit, rishikimin e literatures dhe përmirësimin e kurikulës në masën 20%. Alumni jep gjithashtu mendime për programin e studimit. Punëdhënësit gjithashtu japin opinion mbi cilësinë e studentëve. Zyra organizon takime me alumni. Alumni që vjen për herë të parë plotësojnë një dokument që quhet Formulari i Alumni dhe institucioni krijon databasen e tij.</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen përmes raporteve vjetore dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. (<i>Aneks. VI/5</i>)</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Komisioni për garantimin e cilësisë shfrytëzon të gjitha burimet dhe informacionet e mbledhura dhe përgatit një raport ku evidentoohen jo vetëm rezultatet e vlerësimit, por edhe sugjerimet për përmirësimin e cilësisë. (<i>Aneks. VI/7.1</i>). Raporti më tej diskutohet në nivel Departamenti dhe përbën bazën për të evidencuar nevojat e trainimit të stafit akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.3


Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike. Kjo reflektohet në Raportin vjetor që përgatit Departamenti i Shkencave Mjekësore, dhe më tej raporti në nivel Fakulteti, të cilat janë në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit. <i>(Aneks. II/2)</i> NJSBC për hartimin e raportit të analizës përdor burime të ndryshme informacioni, duke përfshirë këtu edhe pyetësorët e studentëve për mësimdhënien. <i>(Aneks. VI/7)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Metodat që përdoren për kryerjen e vlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - formular vlerësimi i pedagogëve nga drejtuesi i departamentit; - formular vetëvlerësimi; - pyetësorë të vlerësimit të pedagogëve nga studentët; - raport vjetor për përmirësimin e cilësisë së Departamentit; - strategjia e zhvillimit të departamentit; - intervista dhe sondazhe me grupet e interesit dhe sigurisht studentët; <p><i>(Aneks. VI/3; II/24; II/24.2; II/4.2; VI/5 dhe VII/9.2)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime</p>	<p>Metodat e drejtpërdrejta që përdor LOGOS për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit janë intervista, vëzhgime, përpunim statistikor i të dhënave. Vlerësime të tilla janë bërë dhe në periudhën e pandemisë. Kështu studentët kanë vlerësuar pedagogët përmes pyetësorëve dhe anketimeve. <i>(Aneks. VI/5; 6)</i></p>



ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.									
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Metodat e tërthorta që përdor LOGOS për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit bazohen kryesisht në dy pyetësorë: (i) për matjen e performancës së stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi; (ii) për cilësinë e mësimdhënies. LOGOS vlerëson si shumë të rëndësishme vlerësimet dhe sugjerimet e Alumni, si dhe të punëdhënësve për të diplomuarit për Teknikë Laboratori pranë LOGOS. Këto opinione dhe mendime mbledhen gjatë takimeve që organizon Zyra e Këshillimit të Karrierës me këto grupe të sipërpërmendura (<i>Aneks. VII/9; VII/9.3</i>). Zyra gjithashtu kujdeset të mbledhë informacion dhe mbi punësimin e studentëve. Departamenti mban kontakte të mira me institucione bashkëpunuese, gjë që u mundëson studentëve të LOGOS të kryejnë pranë këtyre institucioneve praktikat profesionale, ose u mundëson punësimin studentëve, pas përfundimit të studimeve. (<i>Aneks. VII/11.3; 11.4</i>)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Programet e studimit realizohen në përputhje me rregulloret si ajo e Sigurimit të ciësisë, Statuti, rregullorja e programit të studimit dhe legjislacioni përkatës. (<i>Aneks. VI/1; VI/3; II/1; II/3</i>). Programet mësimore përmirësohen në mënyrë të vazhduar, githashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe	LOGOS përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në




<p>detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit të cilët angazhohen në grupin e punës për të hartuar raportin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit. <i>(Aneks. VI/2.1; 2.2)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Teknikë i Lartë në Laboratorë, përfshihen stafi akademik dhe ndihmës akademik i njësisë bazë dhe kryesore, që është përgjegjëse për programin e studimit, si dhe studentët e programit të studimit. <i>(Aneks. I/15 dhe 15.1)</i>. Për të kryer vlerësimin ngrihet një grup pune në nivel departamenti i cili përbëhet nga 4 anëtarë.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit bëhet duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve., siç është sanksionuar në Rregulloren e KU "LOGOS", Statusin dhe kodin e etikës. <i>(Aneks. II/2; II/1; II/10)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit bëhen pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. LOGOS ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare si Universiteti i Pireut, Selanikut, Trakës etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>KU LOGOS ndjek një politikë transparente për programin e studimit. Në faqen zyrtare të KU LOGOS, në kuadër të SBC, janë të publikuara statuti rregulloret, vendimet e Senatit Akademik, të Bordit të Administrimit. (RVB, fq 67). Informacioni në faqen e institucionit jepet në dy gjuhët: shqip dhe anglisht (Kolegji Universitar LOGOS (kulogos.edu.al)). Në faqen zyrtare. Si shembull të kësaj transparence mund të përmendim disa dokumenta që gjenden në faqen zyrtare të institucionit, si psh: kalendarin akademik (Kalendari.Akademik.2022-2023.pdf (kulogos.edu.al), kriteret e pranimit ndër vite (Pranimet - LOGOS (kulogos.edu.al)) etj. Në faqen zyrtare gjenden informacione të rëndësishme sidomos për studentët, të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin dhe pranimet, transferimi, bursat, struktura e studimeve, çështjet studentore dhe këshillimi për karrierë, mundësi punësimi dhe internship etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>LOGOS publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me Planin e Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Mjekësore, që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. (Aneks. II/4.2).</p> <p>Në këtë strategji të zhvillimit të Departamentit të Shkencave Mjekësore evidentohen qartë objektivat profesionale që kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e cilësisë së njohurive profesionale dhe shkencore të përfuara nga studimet; • Përgatitjen e specialistëve të profilizuar për laboratorët mjekësorë; • Krijimin e figures së ekspertit në fushën e laboratorve;
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të</p>	<p>LOGOS vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, përmes Planit të Zhvillimit të Departamentit për të siguruar përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit (Aneks. II/24. Disa shembuj lidhen me përmirësimin e kurikulës, punësimin e pedagogëve të rinj të kualifikuar.) në</p>



cilësisë së programit të studimit.	fushën e laboratorëve mjekësorë. GVJ kontaktoi disa prej tyre në takimet me stafin akademik. Institucioni ka zgjeruar dhe përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në funksion të mësimdhënies, dhe praktikave laboratorike. GVJ gjatë vizitës në ambjentet e institucionit konstatoi një zhvillim të tillë pozitiv të infrastrukturës laboratorike, si dhe pasurimit të fondit të bibliotekës. Me literature në mbështetje të programit të studimit. Gjatë vizitës në ambjentet e institucionit, GVJ konstatoi angazhimin e stafit akademik me përvojë, por edhe të stafit të ri, në kërkimin shkencor, duke shfrytëzuar më së miri infrastrukturën laboratorike të vetë institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Logos organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe ndihmës akademik, si dhe studentët duke i informuar për arritjet e vetë institucionit, si dhe duke dhënë rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm dhe rritjen e cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. (RVB, fq 67). Gjithashtu GVJ e konfirmoi këtë fakt edhe gjatë vizitës në institucion. <i>(Takimi me NJSBC).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit Bachelor në: “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”


a. Pika të forta:

1. Programi i Studimit Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë organizohet dhe realizohet në një institucion me eksperiencë dhe profilizim 18 vjeçar në fushën e përgatitjes së laborantëve dhe teknikëve të laboratorit me diplomë universitare Bachelor; tradita dhe vazhdimësia janë përparësi;
2. Baza laboratorike për aftësimin profesional për krijimin e specialistëve Teknikë të Lartë Laboratori me kompetencë reale profesionale është në nivele të mira; e plotësuar dhe me mjete didaktike, garanton realizimin me sukses të praktikave laboratorike;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



3. Planet dhe programet mësimore janë hartuar në bazë të modeleve më të mira kombëtare, europiane e më gjerë duke respektuar standartet dhe kuadrin ligjor në fuqi;
4. Stafi në përgjithësi ka kualifikim dhe eksperiencë për realizimin e programit. Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personalitete të spikatur në fushën e mjekësisë laboratorike, si dhe nga mjekë të rinj. Institucioni ndjek një politikë për rinovimin e stafit akademik duke u përballur edhe me vështirësitë për rekrutimin e stafit akademik të specializuar;
5. Vërehet organizim i mirë i brendshëm dhe mirëmenazhim;
6. Institucioni ka një politikë mbështetëse dhe inkurajuese për studentin. Ai i siguron studentit jo vetëm përgatitje teorike por dhe praktikë profesionale në institucione laboratorike në funksion të përgatitjes për tregun aktual dhe perspektiv të punës;
7. Institucioni ka një politikë mbështetëse për kërkimin shkencor që demonstron nga organizimi i konferencave shkencore me pjesëmarrje lektorësh shqiptarë e të huaj ashtu dhe nga mbështetja financiare që iu ka akorduar departamenteve për këtë qëllim;
8. Funksionimi në përbërje të Fondacionit Logos i siguron KU mbështetje dhe garanci financiare;
9. KU Logos ka treguar përgjegjshmëri dhe seriozitet duke përmbushur të gjitha rekomandimet e lëna në akreditimin e parë;

b. Pikat e dobëta:

1. Numri i vogël i partneriteteve aktive shkaktuar dhe nga situata e jashtëzakonshme e pandemisë Covid19. Në institucion konstatoam një frymë pozitive për shtimin e mobilitetit të stafit dhe studentëve si dhe të partneriteteve dhe në funksion dhe të shtimit të mundësive për kërkim shkencor; (*Standarti I.5, kriteri 3*)

Rekomandime

1. GVJ inkurajon institucionin të rrisë përpjekjet për të rekomanduar programin e studimit "Teknikë e Lartë në Laboratorët Mjekësorë" përmes rrugëve të ndryshme, si zgjerimin e kontakteve me shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale, përdorimin e burimeve të ndryshme mediatike, rrjeteve sociale etj;
2. GVJ inkurajon institucionin të rrisë përpjekjet për të aplikuar për projekte të ndryshme kërkimore kombëtare si përmes AKSHI, ose ndërkombëtare duke shfrytëzuar bashkëpunimet që ka me universitete të huaja ndërkombëtare, si psh ato greke;

3. GVJ rekomandon permiresimin e disa elementeve te dokumentacionit, lidhur me planet mësimore (*Standarti 2.1 Kriteri 5*), gjithashtu inkurajon institucionin të rrisë numrin e stafit akademik të kategorisë Profesor, si titullarë të moduleve (*Standarti 2.3 Kriteri 6*)

4.

Conclusions of the Evaluation of the study program "Bachelor" in "Techician for Medical Laboratory"

a. Strengths:

1. The Study Programme Bachelor in High Technique in Medical Laboratories is organized and carried out in an institution with 18-year experience and profiling in the field of preparation of laboratory specialists and technicians with bachelor's degrees; having as the priorities the tradition and continuity;
2. The laboratory infratructure for professional education and for the preparation specialists in High Technique in Medical Laboratories with real professional competence is at good levels; completed and by didactic means, and guarantees the successful implementation of laboratory practices;
3. Plans and curriculums are designed on the basis of the best national, European and broader models respecting the standards and legal framework in force;
4. Generally, the staff have qualification and experience for the implementation of the program. The academic staff involved in this study program comprise prominent personalities in the field of laboratory medicine, as well as by young medical staff. The institution pursues a policy of renovating academic staff, facing difficulties in recruiting specialized academic staff;
5. It is observed a good internal organization and management;
6. The institution has a supportive and encouraging policy for the student. The institution ensure not only a good theoretical education, but also internship in laboratory institutions in order to prepare good specialists for the current and perspeptive labour market;
7. The institution pursue a policy that support the scientific research, which can be confirmed by the organization of scientific conferences with the participation of Albanian and foreign lecturers and with the financial support that it was given to departments for this purpose;
8. The composition of the Logos Foundation provides KU with support and financial guarantees;
9. KU Logos has shown responsibility and seriousness by fulfilling all the recommendations from the first accreditation;

b. Weaknes:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


1. The small number of active partnerships caused by the extraordinary situation of the pandemic Covid 19. At the institution we found a positive spirit for the addition of staff and student mobility, as well as of partnerships which greatly support the increase of opportunities for scientific research; (*Standard I.5, criterion 3*)

Recommendations

1. The EEG encourages the institution to increase efforts to recommend the "High Technical in Medical Laboratories" study programme through various routes, such as expanding contacts with general and vocational high schools, using various media sources, social networks, etc;
2. The EEG encourages the institution to increase efforts to apply for various national research projects such as through ARTI, or internationally by exploiting its collaborations with foreign international universities, such as Greek universities;
3. The EEG recommends some improvement of certain elements of documentation, regarding the teaching plans (*Standard 2.1 Criterion 5*), also encourages the institution to increase the number of academic staff of the Professor category, who are modules leader (*Standard 2.3 Criteria 6*)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X



IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

